



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:206302

Datë: 17.01.2022

Numri i dokumentit: 04159607

PS.nr.16/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Mentor Bajraktari – kryetar i trupi gjykues, Shadije Gërguri dhe Suzana Çerkini – anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore të kësaj gjykate Mirjetë Demiri, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: SH.H, F.H, SH.I që të tre nga fshati .., Komuna e F..dhe B.B nga fshati .., Komuna .., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar 1.2 të Kodit Penal i Republikës së Kosovës¹, ndaj të akuzuarit B.B edhe për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit Nr.05/L-096, ndaj të akuzuarit A.H nga fshati Gremë, Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit SH.H për shkak të veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, si dhe ndaj të akuzuarve SH.B nga fshati .. Komuna e ..dhe A.M nga fshati .. Komuna e .., secili veç e veç për shkak të veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me numër PPS.nr.06/19, të datës 30.05.2019, pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës Atdhe Dema, të akuzuarve si dhe mbrojtësve të tyre avokatëve: Islam Musa, Avni Ibrahim, Rafiz Shehu, Editë Shahini që të gjithë nga Ferizaj, Ahmet Ahmeti nga Prishtina, Fitim Shabani, Kushtrim Obrazhda që dy nga Ferizaj, **me datën 17.01.2022** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

A.PJESA GJYKUESE

Të akuzuarit:

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK-së), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

1. SH.H, nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën .. në .. tani me vendbanim në fshatin ... Komuna e Ferizajt, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .., ka qenë në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 06.12.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 07.12.2019 deri me datën 06.02.2020.

2. F.H, nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën .. në qytetin ..., tani me vendbanim në fshatin ..., Komuna .. pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .. ka qenë në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 24.04.2020.

3. B.B, nga i ati .., e ëma .. e vajzërisë .. i lindur me datën .., në fshatin .. Komuna e .., ku edhe tani banon në rrugën “.., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: .., ka qenë në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 06.12.2019 dhe në arrest shtëpiak nga data 07.12.2019 deri me datën 06.02.2020.

4. A.H, nga i ati ..dhe ëma .. e vajzërisë .. i lindur me datën .. në fshatin .. Komuna .. ku edhe tani banon, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, zdrukthëtarë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..

5. SH.B, nga i ati .. e ëma .. vajzërisë ..., i lindur me datën .. në Prishtinë, tani me vendbanim në fshatin .. Komuna .. i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si kamerier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ...

6.A.M, nga i ati .. e ëma .. e gjinisë .. i lindur me datën .. në .., Komuna e .. ku edhe tani banon, i pa martuar, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ..

JANË FAJTOR

I. Të akuzuarit SH.H dhe B.B nga data 16.05.2018 e deri me 07.10.2018, **ndërsa i akuzuari F.H** nga data 09.06.2018 e deri me datën 07.10.2018, duke vepruar në grup së bashku edhe me të akuzuarit B.J dhe P.H, në vazhdimësi, me dashje, në F.. dhe K.. dhe fshatra të këtyre komunave, pa autorizim kanë transportuar dhe shitur substanca narkotike të llojit kokainë dhe kanabis (marihuanë), ashtu që sipas marrëveshjes paraprake duke i ndarë rolet të njëjtit paraprakisht janë furnizuar me këto substanca narkotike në Republikën e Shqipërisë, ashtu që të akuzuarit B.B dhe F.H kanë bërë sigurimin e të substancave narkotike në Shqipëri, ndërsa i akuzuari B.J ka bërë transportimin e substancave narkotike nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, ku i njëjti është ndaluar për kontroll në vendkalimin kufitar “... me datën 07.10.2018, në ora 20:15 minuta, me automjetin e modelit .. me targa të regjistrimit .. dhe në automjet i është gjetur substancë narkotike kokainë në sasi prej 549.44 ± 0.0001 gram, ndërsa akuzuarit SH.H dhe P.H të cilët kanë pasur rolin e shpërndarjes dhe shitjes në vendet e lartpërmendura, ashtu që paraprakisht në të njëjtën kohë është bërë kontrolli dhe bastisja e hapësirës-banesës të akuzuarve SH.H dhe P.H në F.., në rrugën ...banesë e marrë me qira nga i

pandehuri Shp.. me qëllim që e njëjta të shfrytëzohet edhe nga të akuzuarit tjerë për të ushtruar këtë veprimtari kriminale, në këtë banesë janë sekuestruar substancat narkotike: kokainë në sasi prej 2+0.0001 gram si dhe substanca/preparati narkotik kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në sasi neto 5.54+0.0001 gram, si dhe peshore dhe aksesore tjerë të cilat kanë shërbyer për matjen, renditjen, ndarjen dhe sistemimin e këtyre substancave narkotike, veprime këto me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për njëri-tjetrin.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në vazhdimësi nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

II. I akuzuari B.B, sepse nga data e pacaktuar deri më datën 07.10.2018, në shtëpinë e tij në fshatin .., Komuna e .., në kundërshtim me ligjin mbi armët, në mënyrë të paautorizuar ka mbajtur në posedimin armë dhe atë: një (1) revole e tipit Zastava M-57, e kalibrit 7.62 mm, me numër serik: H-99359, me një (1) karikatorë dhe nëntë (9) fishek të kalibrit 7.62 mm, një (1) revole e kalibrit 6.35 mm, me numër serik: 493788, me një (1) karikatorë dhe katër (4) fishekë, dyzetënjë (41) fishekë të kalibrit 7x64mm si dhe gjashtë (6) fishekë të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12 mm, të cilat janë sekuestruar nga policia.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

III. I akuzuari A.H, sepse me datë 29.09.2018, në ora 18:20 minuta, në shtëpinë e tij në fshatin ... Komuna .. me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit SH.H, me qëllim të shpërndarje narkotiku të llojit "Marihunë", duke i krijuar kushte për shpërndarje, ashtu që i njëjti ka pranuar nga i akuzuari Sh..... substancë narkotike në peshë prej 5.54 gram, të cilën substancë pastaj i akuzuari A... ka vendosur dhe sistemuar në figurat e shahut, me qëllim që i akuzuari Sh..... tabelën e shahut ta dërgoj në qendrën korrektuese në Dubravë, tek i dënuari M.A i cili ishte në vuajtje të dënimit në këtë qendër, kurse kjo sasi e fshehur në figura së bashku me tabelën e shahut, është gjetur në banesën e të akuzuarit SH.H me rastin e bastisjes nga ana e Policisë së Kosovës dhe e cila pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë substancë/preparat narkotik kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në sasi neto 5.54+0.0001 gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: ndihmë në kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

IV. I akuzuari SH.H, sepse nga data 18.10.2016 e deri më 29.06.2018, në vazhdimësi ka bartur-transferuar përfitimin e kundërligjshëm tek xhirollogaria me numër 1... NLB Bank e të akuzuarit A.M, me qëllim të fshehjes, të maskimit të natyrës apo të burimit të pasurisë, në vlerë prej 36,875.00 Euro, me marrëveshje paraprake në mes njëri-tjetrit, e për të cilat të ardhura nuk ka prova se janë nga ndonjë aktivitet i rregullt ekonomik ose burim tjetër i ligjshëm i njohur, si dhe

në marrëveshje me të akuzuarin SH.B po ashtu ka bartur përfitimin e kundërligjshëm, tek xhirollogaria e tij me numër ... Bankën Ekonomike, në shumë prej 7,000 Euro, për të cilat gjithashtu nuk ka prova të fitimit në mënyrë ligjore, përkundrazi në të dyja rastet pasuri kjo e fituar në mënyrë të kundërligjshme nëpërmjet veprimtarisë së kundërligjshme të trafikimit me narkotik dhe shndërrimin e një pjese të të ardhurave në pasuri të luajtshme (automjete), për të cilat të ardhura nuk ka dëshmi se janë nga ndonjë aktivitet i rregullt ekonomik ose burim tjetër i ligjshëm i njohur dhe në këtë mënyrë i akuzuari SH.H përmes të akuzuarve tjerë ka përdorur të ardhurat nga aktivitete të dyshuara ashtu që nga veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotik ka përfituar mjete financiare, ku përpos deponimeve në xhirollogaritë e dy të akuzuarve, ka përfituar edhe sende të luajtshme-automjete: **1.** BMW 328, ngjyrë hiri, me targa ..., viti i prodhimit 1998, numri i shasisë .., data e pronësisë 20.07.2017; **2.** BMW 120 D, ngjyrë e kaltër, me targa .. viti i prodhimit 2008, numri i shasisë... data e pronësisë 14.08.2018, automjet ky i doganuar dhe regjistruar në emër të personit SH.B dhe nga të gjeturat në fazën hetimore nuk ka dëshmi se ka biznes të regjistruar në Kosovë, nuk ka importe të realizuara në Doganën e Kosovës si dhe nuk është i evidentuar në regjistrin e të drejtave të pronësisë së paluajtshme.

Me këto veprime ka kryer veprën penale shpëlarje e parasë nga neni 308 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

V. I akuzuari SH.B, sepse në kohën dhe vendin të përshkruar si në pikën IV të aktgjykimit, me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit SH.H, duke deponuar në xhirollogarinë e tij me numër ... në Bankën Ekonomike, shumën prej 7,000 Euro, të cilat para kanë qenë të akuzuarit SH.H, si dhe po ashtu me kërkesë të të akuzuarit SH.H e ka doganuar dhe regjistruar në emër të tij, automjetin BMW 120 D, ngjyrë e kaltër, me targa ..., viti i prodhimit 2008, numri i shasisë..., data e pronësisë 14.08.2018, e gjithë kjo pas marrëveshjes paraprake të cilën e kanë arritur të dy, me qëllim të fshehjes, të maskimit të natyrës apo të burimit të pasurisë të fituar nga aktivitetet e dyshuara nga veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotik të të akuzuarit SH.H, për të cilat mjete i akuzuari Shkumbin ka pasur arsye për të ditur se pasuria-paratë të cilat i kishte deponuar në llogarinë e tij dhe automjeti kanë qenë pasuri e fituar në formë të aktivitetit kriminal.

Me këto veprime ka kryer veprën penale shpëlarje e parasë nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.6 lidhur me 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

VI. I akuzuari A.M, sepse në kohën dhe vendin të përshkruar si në pikën IV të aktgjykimit, me dashje i ka ndihmuar të akuzuarit SH.H, duke pranuar në xhirollogarinë e tij me numër ...në NLB Bank, bartjen e shumës prej 36,875.00 Euro nga i akuzuari SH.H dhe këtë me qëllim të fshehjes, të maskimit të natyrës apo të burimit të pasurisë, të fituar nga aktivitetet e dyshuara nga veprimtaria e kundërligjshme, konkretisht trafikimi me narkotik, veprim këtë të kryer me dashje, pas marrëveshjes paraprake të cilën e kanë arritur të dy, për të cilat mjete i akuzuari A....ka pasur

arsye për të ditur se pasuria-paratë të cilat i kishte deponuar në llogarinë e tij kanë qenë pasuri e fituar në formë të aktivitetit kriminal.

Me këto veprime ka kryer veprën penale shpëlarje e parasë nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.6 lidhur me 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së, Gjykata fillimisht të akuzuarve SH.H dhe B.B, i'u përcakton dënimet si në vijim:

Të akuzuarit SH.H,

- Për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **dënimin me gjobë në shumë prej tremijë (3000) Euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite e gjashtë (6) muaj.**
- Për veprën penale shpërlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, të përshkruar si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **dënimin me gjobë në shumë prej dhjetëmijë (10.000) Euro dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj.**

Të akuzuarit B.B,

- Për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite dhe dënimin me gjobë në shumë prej dymijë (2000) Euro.**
- Për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, **dënimin me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) Euro.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 6, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 45, 46, 62 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, 69, 73, 74, 80 par.1 dhe par.2, 83, 96, 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1, 374 par.1 dhe 3, 273 par.1 lidhur me neni 33 të KPRK-së, **308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.2, 1.5, 1.6 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave**

dhe luftimit të financimit të terrorizmit, si dhe neneve 282 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.2, 360 par.2 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale², të akuzuarit i:

G J Y K O N

1. Të akuzuarin SH.H,

ME DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej trembëdhjetëmijë (13.000) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) vite e dhjetë (10) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 06.12.2019, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.12.2019 deri me datën 06.02.2020.

2. Të akuzuarin F.H,

ME DËNIM GJOBË, në shumë prej tremijë (3.000) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 24.04.2020.

3. Të akuzuarin B.B,

ME DËNIM UNIK ME GJOBË, në shumë prej dymijegjashtëqind (2.600) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 07.10.2018 deri me datën 06.12.2019, si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 07.12.2019 deri me datën 06.02.2020.

4. Të akuzuarin A.H,

ME DËNIM GJOBË, në shumë prej njëmijë (1.000) Euro, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

² Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejshëm KPP-së, nr.04/L-123, i datës 13.01.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit konform nenit 47 të KPRK-së, **dënimi me burgim** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, **I ZËVENDËSOHET me dënim me gjobë** në shumën prej dymijë (2000) Euro.

Andaj, gjykata konform nenit 80 par.1 dhe par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, për dënimin me gjobë dhe dënimin e zëvendësuar me gjobë të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN UNIK ME GJOBË në shumë prej tremijë (3000) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej një (2) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5. Të akuzuarin SH.B,

ME DËNIM GJOBË, në shumë prej dymijë (2.000) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti.

6. Të akuzuarin A.M,

ME DËNIM GJOBË, në shumë prej dymijë (2.000) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Nëse të akuzuarit e lartpërmendur, nuk dëshirojnë ose nuk mundën ti paguajnë dënimet me gjobë apo dënimet unike me gjobë, atëherë të akuzuarve dënimet me gjobë apo dënimet unike me gjobë iu zëvendësohen secilit veç e veç me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro, ashtu që:

- 1.** Të akuzuarit SH.H, i zëvendësohet dënimi unik me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtëqindpesëdhjetë (650) ditëve.
- 2.** Të akuzuarit F.H, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditëve.
- 3.** Të akuzuarit B.B, i zëvendësohet dënimi unik me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetridhjetë (130) ditëve.
- 4.** Të akuzuarit A.H, i zëvendësohet dënimi unik me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditëve.
- 5.** Të akuzuarit SH.B, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditëve.
- 6.** Të akuzuarit A.M, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditëve.

I. Ndaj të akuzuarve SH.H, F.H dhe P. H., KONFISKOHEN:

1. Substanca narkotike e llojit “Kokainë” në peshë neto të përgjithshme prej 2 ± 0.0001 gram;
2. Shuma e parave në vlerë prej tremijë e njëqind e dhjetë (3110) €uro;
3. Një (1) peshore digjitale.

II. Ndaj të akuzuarit B.B, **KONFISKOHEN:**

1. Një (1) revole e tipit Zastava M-57, e kalibrit 7.62 mm, me numër serik: H-99359, së bashku me një (1) karikatorë dhe nëntë (9) fishek të kalibrit 7.62 mm;
2. Një (1) revole e kalibrit 6.35 mm, me numër serik: 493788, së bashku me një (1) karikatorë dhe katër (4) fishek, dyzetënjë (41) fishek të kalibrit 7x64mm si dhe gjashtë (6) fishek të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12 mm;
3. Një peshore digjitale ngjyrë të kaltër në të hirit;
4. Para në shumë prej 836 €uro e 5 cent, dhe atë me bankënotat si në vijim 7x100 €uro, 2x50 €uro, 1x20 €uro, 1x10 €uro, 1x5 €uro, 1x1 €uro, 1x5 cent, 170 Denar të Maqedonisë,
5. Një (1) Telefoni Iphone 7, ngjyrë e zezë me IMEI: 35804082621000;
6. Një (1) Telefon Samsung, GT-1080, me numër serik 89355020000276436837025;
7. Një (1) Telefon Samsung, ngjyrë ari.

III. Ndaj të akuzuarit F.H të **KONFISKOHEN:**

1. Një (1) automjet i markës “Audi 4”, tipi B8, ngjyrë e zezë metalike, me numër identifikues të automjetit .. me targa të regjistrimit .., e cila është pronë e të akuzuarit F.H por që evidentohet në emër të B.A
2. Një (1) telefon Samsung Galaxy S8, ngjyrë e zezë, IMEI:35...;
3. Një (1) jelek antiplumb ngjyrë të kaltër.

IV. Ndaj të akuzuarve SH.H të **KONFISKOHEN:**

1. Një (1) automjeti i markës BMW 187, me targa .., ngjyrë e kaltër, viti 2008, me numër identifikues të automjetit ..
2. Një (1) automjet i markës BMW 328, me targa..., ngjyrë hiri, viti 1998, VIN n...
3. Një (1) telefon Iphone 6s, ngjyrë ari-vjollce;
4. Një (1) telefon Iphone 7 plus, ngjyrë e bardhë;
5. Një telefon Iphone 5, ngjyrë Ari, me SIM kartelë , IMEI:35...;
6. Një (1) telefon Samsung Duos E0168, ngjyrë e bardhë;
7. Një (1) Samsung G850F, ngjyrë e bardhë, pa kartel, me numër IMEI:35..., të gjitha si objekte të kryerjes së veprave penale.

V. Po ashtu në këtë çështje **KONFISKOHEN:**

1. një (1) telefon Iphone 6, ngjyrë e bardhë,
2. një telefon (1) Nokia ngjyrë e zezë,
3. një (1) Iphone 6 ngjyrë hiri.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, **OBLIGOHET** që t'i marr nën administrim dhe menaxhim sendet e konfiskuara përkatësisht paratë dhe pasuritë, si në pikën I, II, III, IV dhe V, Agjencia ka të drejtë që administrojë me të njëjtat dhe me sendet e lartcekura t'i shesë dhe paratë nga shitja t'i administroi në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

REFUZOHET kërkesa për konfiskimin e shtatëdhjetepesëmijë (75.000) Euro apo ekuivalenti i kësaj shume, **si e pabazuar me ligj.**

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumën prej treqind (300) Euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

B.PJESA LIRUESE

I.

I akuzuari SH.I, nga i ati ..., e ëma ... e gjinisë ... i lindur me datën ... në Prishtinë, me vendbanim në fshatin .., Komuna e .., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ...

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për pikën I të aktakuzës:

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse nga data 16.05.2018 e deri më 07.10.2018, në vazhdimësi, me dashje, në F.., dhe fshatra të këtyre komunave, pa autorizim kanë transportuar dhe shitur substanca narkotike të llojit kokainë dhe kanabis (marihuanë), ashtu që sipas marrëveshjes paraprake, duke i ndarë rolet, paraprakisht janë furnizuar nga Republika e Shqipërisë, fakti zbuluar gjatë zbatimit të urdhër kontrollit nga ana e policisë, e me ç'rast i pandehuri i parë është ndaluar për kontroll në vendkalimin kufitar "Vërmicë" në ora 20:15, automjeti modeli: Audi, tipi "A4", targa të regjistrimit .. dhe i është gjetur substancë narkotike kokainë në sasi prej 549.44+0.0001 gram, kurse paraprakisht në të njëjtën kohë është bërë kontrolli dhe bastisja e hapësirës së të pandehurve të tjerë në .., në rrugën "..", banesë e marrë me qira nga i pandehuri Sh..., me qëllim që e njëjta të shfrytëzohet edhe nga të pandehurit tjerë për të ushtruar këtë veprimtari kriminale, ku është sekuestruar substanca narkotike kokainë në sasi prej 2+0.0001 gram si dhe substanca /preparati narkotik kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në sasi neto 5.54+0.0001 gram si dhe peshore dhe aksesore tjerë të cilat kanë shërbyer për matjen, renditjen, ndarjen dhe sistemimin e këtyre substancave narkotike, veprime këto me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për njëri-tjetrin.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në vazhdimësi nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

II.

I akuzuari B.B, nga i ati .., e ëma .. e vajzërisë .. i lindur me datën .., në fshatin .. Komuna e .. ku edhe tani banon në rrugën “.., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal: ...

Në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, për pikën VII të aktakuzës:

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse nga data 12.09.2016 ka në pronësi automjetin IMT 539, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit .., numri i shasisë .., viti i prodhimit 2009 si dhe që nga data 12.09.2017 ka në përdorim automjetin Audi A4 2.7 TDI, numri i shasisë .., viti i prodhimit 2008, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit .., e regjistruar në emër të H.B (motrës së tij), e nga të gjeturat hetimore nuk ka prova se të njëjtat janë blerë si rezultat nga ndonjë aktivitet i rregullt ekonomik ose burim tjetër i ligjshëm i njohur, por nga të ardhurat e aktiviteteve të dyshuara-veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotik.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale Shpëlarje e parasë nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin nga neni 56 par 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit.

Të akuzuarit B.B, I KTHEHEN:

1. Një (1) Automjet IMT 539, ngjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit .., nr. i shasisë .., viti i prodhimit 2009;
2. Një (1) Automjet “Audi” A4 2.7 TDI, nr.i shasisë .., viti i prodhimit 2008, ngjyrë hiri me targa të regjistrimit ...

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, **OBLIGOHET** që t`ia dorëzojë të akuzuarit sendet e lartpërmendura meqenëse nuk ka bazë ligjore për konfiskimin e tyre.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj gjykate me datën 31.05.2019, ka ngritur aktakuzën me numër PPS.nr.06/2019, të datës 30.05.2019, ndaj të akuzuarve B.J nga fshati .., Komuna .., SH.H, F.H, P.H, SH.I që të katër nga fshati .., Komuna e ..dhe B.B nga

fshati..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar.1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit B.B edhe për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit Nr/05/L-096, ndaj të akuzuarit A.H nga fshati .., Komuna e .. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit SH.H për shkak të veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.5 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit Nr/05/L-096, ndaj të akuzuarve SH.B nga fshati ... Komuna e ..dhe A.M nga fshati .., Komuna e .., secili veç e veç për shkak të veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit Nr/05/L-096.

Pas ngritjes së aktakuzës, është caktuar shqyrtimi fillestar, i cili është mbajtur më datën 06.11.2019, në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në të cilin të akuzuarit B.J, P.H, SH.H, B.B pas konsultimit me mbrojtësit e tyre kanë pranuar fajësinë për veprën penale sikurse në pikën I të aktakuzës, ndërsa i akuzuari B.B e ka pranuar edhe për veprën penale në pikën II të aktakuzës. Ndërsa të akuzuarit tjerë F.H, SH.I për pikën I, B.B për pikën VII, dhe SH.B dhe A.M nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale me të cilat ngarkohen, ashtu që gjykata ka caktuar shqyrtimin e dytë me datën 06.12.2019 dhe i ka udhëzuar të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre që t'i paraqesin me shkrim kundërshtimet ndaj provave konform nenit 249 të KPP-së dhe kërkesat për hedhjen e aktakuzës konform nenit 250 të KPP-së.

Me Aktvendimin e kësaj gjykate me numër 43/2019, të datës 06.11.2019 konform nenit 36 të KPP-së, është veçuar procedura penale, ndaj të akuzuarve B.J dhe P.H për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar. 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që është vendosur që procedura ndaj tyre të zhvillohet sipas numrit të ri PS.nr.43/19, ndërsa për të akuzuarit tjerë të vazhdoj procedura sipas numrit të vjetër PS.nr.16/19.

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate PS.nr.43/19, të datës 11.11.2019, të akuzuarit B.J dhe P.H janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar. 1.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit janë gjykuar, i akuzuari B.J me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) viteve, në të cilin dënim është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.10.2018 deri më 11.11.2019, ndërsa i akuzuari P.H me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) vite e gjashtë (6) muaj në të cilin dënim është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.10.2018 deri më 11.11.2019. Të njëjtit janë obliguar të paguajnë shpenzimet e procedurës penale secili veç e veç shumën prej 200 Euro, në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Po ashtu bazuar në nenin 69 të KPRK-së dhe 115 të KPP-së është konfiskuar

substancia narkotike kokainë në sasi neto 549.44+0.0001 gram, dhe substancia narkotike kanabis (Marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në sasi neto 5.54+0.0001 gram.

Mbrojtësit e të pandehurve avokatët Islam Musa, Avni Ibrahim, Rafiz Shehu, Editë Shahini, Ahmet Ahmeti, Fitim Shabani dhe Ekrem Shabani me shkrim pranë kësaj gjykate kanë parashtruar kërkesat e tyre për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave.

Pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë me datë 06.12.2019, kryetari i trupit gjykues, me datën 20.12.2019 ka marrë aktvendim me të cilin i ka refuzuar kërkesat për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet ndaj provave të mbrojtësve të të akuzuarve, si të pa bazuara.

Shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale ka filluar më datën 11 Maj 2021³, ashtu që në shqyrtim kanë marrë pjesë Prokurori i shtetit nga PSRK, të akuzuarit si dhe mbrojtësit e tyre të cilët janë shënuar si në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi.

Prokurori Special Atdhe Dema, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtorë për veprat penale dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 11 Maj 2021, Prokurori ka bërë përmirësimin e kualifikimit juridik të pikës I të aktakuzës duke theksuar se në kualifikimin juridik të veprës penale ku qëndron bashkëkryerja dhe grupi për hir të procedurës dhe legalitetit fjalën “bashkëkryerje dhe nenin 31 të KPRK-së tek kualifikimi juridik në pikën I” këto fjali duhet të hiqen nga aktakuza, ngase nga përshkrimi faktik kemi të bëjmë me grup, ashtu që kualifikimi juridik në pikën I të aktakuzës duhet të jetë “me çka kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar.1.2 të KPRK-së”.

Po ashtu, gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 24 Dhjetor 2021, Prokurori ka bërë përmirësimin përkatësisht qartësimin e pikës V dhe VI të aktakuzës që kanë pasur të bëjnë me të akuzuarit SH.B dhe A.M, duke theksuar se në pikën V që ka të bëjë me ta akuzuarin SH.B, dhe në pikën VI që ka të bëjë me të akuzuarin A.M në fillim të këtyre dispozitiveve të aktakuzës duhet ti shtohen edhe fjalët “në vendin, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në pikën IV të aktakuzës që kemi të bëjmë me SH.Hn”, të cilit ia transferojnë në një formë apo formë tjetër shumat e parave dhe pas kthimin e këtyre shumave që kanë të bëjnë me kohën.

I akuzuari SH.H, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për pikën I të aktakuzës, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për pikën IV të aktakuzës.

³ Të gjitha procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në nenin 315 par.1 të KPP-së, pra seancat e shqyrtimit gjyqësor janë përpiluar me shkrim të cilat procesverbale gjenden në shkresa e lëndës ashtu që shqyrtimi gjyqësor nuk është regjistruar me audio ose video për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve në gjykatë në kohën kur janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor.

I akuzuari F.H, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë.

I akuzuari B.B, gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar fajësinë për veprat penale nga pika I dhe II të aktakuzës, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për pikën VII të aktakuzës.

Të akuzuarit SH.I, A.H, SH.B dhe A.M, gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 11 Maj 2021, ka refuzuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve SH.H dhe B.B lidhur me pikën I të aktakuzës, për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar 1.2 të KPRK-së, ngase trupi gjykues ka vlerësuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve nuk mund të bëhet sepse është e nevojshme të bëhet vërtetimi i disa rrethanave faktike të përshkruara në aktakuzë e në veçanti të grupit, ngase veprimet e të akuzuarve në aktakuzë kanë qenë se të njëjtit duke i ndarë rolet kanë vepruar në grup, prandaj është dashur të vërtetohet ky fakt se si të njëjtit kanë vepruar dhe po ashtu duke marrë për bazë se të akuzuarit SH.H dhe B.B e ka pranuar fajësinë sipas kësaj pike të aktakuzës, ndërsa të akuzuarit F.H dhe SH.I, nuk e kishte pranuar fajësinë gjatë gjithë fazave të procedurës lidhur me këtë veprë penale është dashur të vërtetohet se këta të fundit a kanë qenë pjesë e grupit dhe kanë vepruar në grup, mirëpo gjykata ka konstatuar se vendimi mbi refuzimin e pranimit të fajësisë nuk do humbë benefitet që i gëzojnë të akuzuarit me pranimin e fajësisë, në këtë fazë të procedurës dhe gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, ngase pranimi i fajësisë do të merren për bazë gjatë matjes së dënimit pas përfundimit të këtij shqyrtimi gjyqësor, ashtu edhe siç është vepruar në këtë rast.

2. Fjala përfundimtare e palëve⁴

Prokurori Special Atdhe Dema, në fjalën përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësorë, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve duke theksuar se pas administrimit të të gjitha provave në këtë çështje penale duke u zbatuar të gjitha rregullat e përgjithshme të KPP-së, vlerësoj se janë provuar dhe vërtetuar në tërësi gjendjet faktike e përshkruar si në dispozitivin I, II, III dhe IV të aktakuzës se të akuzuarit me dashje kanë kryer veprat penale, dhe se në veprimet e të akuzuarve plotësohen të gjitha elementet esenciale të veprave penale që ju vihen në barrë si në aktakuzë. Nga provat e nxjerra në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar në mënyrë të plotë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale si në aktakuzë. Të njëjtit kanë vepruar secili në mënyrë të organizuar, ashtu që fillimisht kanë organizuar dhe ndarë përgjegjësitë e tyre e që në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen. Veprimet e tyre të kundërligjshme janë vërtetuar në tërësi nga të gjitha provat e prezantuara dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor siç janë: deklaratat e dëshmitarëve, transkriptet e bisedave të përgjuara telefonike, komunikimi i vazhdueshëm në mes tyre, të dhënat financiare për të akuzuarit B.J (nga NLB Bank), SH.H (nga NLB Bank), F.H (nga ProCredit Bank), P.H (nga Western Union), B.B (nga ProCredit Bank), SH.B (nga Banka Ekonomike),

⁴ Prokurori i shtetit, si dhe mbrojtësit e të akuzuarve, fjalën përfundimtare trupit gjykues ia kanë dorëzuar edhe në formë të shkruar.

A.M (nga NLB Bank) nga raporti përmbledhës i hetimeve financiare si dhe deklarimi i vet të akuzuarve, si në procedurë hetuese e po ashtu edhe në shqyrtim gjyqësor (pra ata që u deklaruan), e në bazë të të cilave është vërtetuar se të njëjtit duke vepruar në vazhdimësi e në bashkëkryerje kanë kryer këto vepra penale. Po ashtu si pika më të rëndësishme ka cekur faktin se të akuzuarit kanë motivuar njëri-tjetrin të merren me veprime kundërligjore për të arritur përfitime pasurore financiare, e për të arritur këtë qëllim kanë përdorur qytetarë të moshës së re e me kushte të dobëta ekonomike, ashtu që fitimin e realizuar në mënyrë të kundërligjshme kanë tentuar ta maskojnë kinse me dhënie borgji etj. Prokuroria i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shpallë fajtorë për veprat penale me të cilat ngarkohen duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe t'i dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.H, av.Islam Musa, në fjalën e tij përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se sa i përket veprës penale nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 e lidhur me nenin 31 të KPRK, i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, të cilin pranim trupi gjykues e ka refuzuar, mirëpo nga gjykata kërkon që ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për atë vepër penale. Ndërsa sa i përket veprës penale të shpëlarjes së parave, nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale me aktivitete të kundërligjshme të trafikimit me narkotik duke përfituar mjete financiare në shumën prej 75,000.00 Euro. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se babai i të akuzuarit Sh..., e ka shitur një paluajtshmëri në çmim prej 18,478.00 Euro si dhe fakti se i akuzuari gjatë vitit 2015 ka marrë kredi në shumën prej 4,000.00 Euro, ka punuar më se dy vite në SH.P.K “.. në F.. dhe ka realizuar pagë mujore prej 275.00 Euro. Thekson po ashtu se i mbrojturi i tij ka dy vëllezër në Zvicër të cilët me vite punojnë atje dhe gjithnjë i kanë sjellë para të mbrojturit të tij. Andaj i propozon gjykatës që në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP të merr aktgjykim lirues lidhur me këtë vepër penale.

I akuzuari SH.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit av.Islam Musa, nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.H, av.Avni Ibrahim, në fjalën e tij përfundimtare të cilën e kishte përgatitur me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar.1.2 të KPRK. Dëshmitarët e propozuar në aktakuzë: H.B, I.H, E.S, E.H, L.K, B. F, A.P, A.Rr dhe B.A, në deklaratat e tyre të dhëna në fazën e hetimeve dhe në shqyrtimin gjyqësor nuk prezantojnë asnjë rrethanë se i akuzuari F.H ka qenë i përfshirë në çfarëdo mënyre në ngjarjen kritike që është objekt i akuzës madje disa prej dëshmitarëve as që e njohin të akuzuarin F.H. Po ashtu nga deklaratat e të akuzuarve B.J, SH.H, P.H, B.B, Shkëlqim Ilazi dhe A.H nuk prezantohet as tërthorazi ndonjë rrethanë që do të tregonte se i pandehuri F.H ka qenë i përfshirë si anëtar i grupit në veprime kriminale. Nga përmbajtja e provave materiale përkatësisht transkriptuat e bisedave telefonike, raportet e vëzhgimit-monitorimit, dhe provave tjera nuk ekziston asnjë rrethanë që vërteton apo tregon pjesëmarrjen apo implikimin e të akuzuarit F.H në veprimet e inkriminuara në aktakuzë. Nuk është prezantuar asnjë provë në shqyrtimin gjyqësor se vetura e cila është sekuestruar nga i akuzuari F.H, është përdorur si mjetë për kryerjen e veprës penale dhe

kundër kësaj prokuroria me aktakuzë ka propozuar sekuestrimin dhe konfiskimin e përhershëm të veturës. Nga arsyet e lartpërmendura ka propozuar që në mungesë të provave të akuzuari të lirohet nga akuza.

I akuzuari F.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit av.Avni Ibrahimimi, nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B, avokati Rafiz Shehu, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim e të cilën e ka elaboruar në shqyrtim gjyqësorë ka deklaruar se meqenëse për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK e ka pranuar fajësinë dhe gjykata ka aprovuar të njëjtin, t'i jepet dënim minimal me gjobë ndërsa për veprat penale nga dispozitivi I dhe VII të aktakuzës, në mungesë të provave i propozon gjykatës të merr aktgjykim lirues. Gjatë shqyrtimit gjyqësor asnjë i dëmtuar, dëshmitar ose i akuzuar nuk ka cekur se i mbrojturi i tij ka kryer ndonjëherë nga veprat penale. Organet hetimore në momentin e arrestimit dhe kontrollit nuk i kanë gjetur substancë narkotike të mbrojturit të tij, e po ashtu nuk ka mundur të vërtetohet se prej kujt ka blerë lëndë narkotike apo kujt i ka shitur-shpërndarë. Sa i përket të akuzuarit B.J i cili e kishte pranuar veprën penale duke involvuar edhe të akuzuarin B.B, mbrojtja konsideron se këtë e ka bërë për të shfajësuar vetveten andaj, kjo nuk mund të merret si provë valide. Nga arsyet e lartpërmendura ka propozuar që në mungesë të provave i akuzuari të lirohet nga akuza.

I akuzuari B.B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit av.Rafiz Shehu nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësja e të akuzuarit SH.I., avokatja Editë Shahini, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të njëjtën të elaboruar gojarisht në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se pretendimet e prokurorisë janë tërësisht të pabazuara. Tani më është vërtetuar se i mbrojturi i saj në ditën kritike gjatë ndërhyrjes së policisë në banesën në të cilën janë arrestuar të akuzuarit, ka qenë vetëm për vizitë dhe nuk ka pasur asnjë njohuri për veprimtarinë e cila është zhvilluar në atë banesë. I mbrojturi i saj nuk ka qenë pjesë e hetimeve që janë zhvilluar për të akuzuarit tjerë dhe nga deklaratat e të gjithë dëshmitarëve u vërtetua se të njëjtit as nuk e njohin, as nuk kanë pranuar ndonjëherë narkotik nga i mbrojturi i saj. Po ashtu edhe nga deklaratat e të akuzuarve tjerë është vërtetuar se SH.I, nuk ka qenë në dijeni për narkotikët, por i njëjti ka qenë mysafir në atë banesë tek shoku i tij. Andaj në mungesë të provave i propozon gjykatës që të nxjerrë aktgjykim lirues.

I akuzuari SH.I, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij av.Editë Shahini nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.H, avokati Ahmet Ahmeti në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të njëjtën të elaboruar gojarisht në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka ndërmarr veprimet inkriminuese që i pretendon prokuroria. Nga vet deklarata e të akuzuarit SH.H e dhënë në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se ai vet ka shkuar tek i akuzuari A.H duke i kërkuar atij hapjen e vrimave të shahut, por pa i treguar atij për qëllimin e kërkesës së tij, sikur që nuk i ka dorëzuar atij sasinë prej 7.6 gram të substancës narkotike me qëllim që pastaj ajo sasi të përdorej për qëllimet që prokuroria pretendon. Po ashtu figurat e shahut të mbushura me substancë narkotike nuk janë sekuestruar nga i mbrojturi i tij por nga të akuzuar tjerë. As në transkriptet e bisedave të dt.29.09.2018 mes SH.Ht dhe M.A që i

adresohen mbushjes-sistemimit të lëndës narkotike në figurat e shahut, në asnjë moment nuk përmendet emri i A.H. Andaj meqë në veprimet e të mbrojturit të tij nuk karakterizohet dashja e as pasoja, pra mungon lidhja kauzale shkak-pasojë, gjykatës i propozon që të nxjerrë aktgjykim lirues ndaj të mbrojturit të tij A.H.

I akuzuari A.H, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit së tij av.Ahmet Ahemeti, nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit SH.B, avokati Fitim Shabani në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të njëjtën të elaboruar gojarisht në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari Sh... kishte të deponuara shumën prej 7000 Euro në llogarinë e tij, të cilat mjete ishin të Sh..., dhe ky transaksion ishte bërë pasi që i akuzuari SH.B kishte për qëllim që të bënte një deponim në llogarinë e tij bankare me qëllim që të rregulloj pasqyrën bankare e më pastaj të aplikonte për vizë. Sa i përket regjistrimit të automjetit BMW në emër të akuzuarit Sh..., këtë ia kishte kërkuar i akuzuari Sh..pasi që ky i fundit ia kishte huazuar paratë andaj dhe i njëjti nuk ka mundur ta regjistroj në emër të vet ngase kishte gjoba të cilat ia pamundësonin regjistrimin. Andaj në veprimet e të mbrojturit të tij nuk ka ekzistuar dashja dhe as dijenia që paratë janë rrjedhojë e ndonjë aktiviteti kriminal, por shërbimet që ia ka ofruar të akuzuarit Sh..kanë qenë vetëm mbi bazën e shoqërisë. Për këto arsye bazuar në nenin 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së, kërkon nga gjykata që të njëjtin ta liron nga akuza.

I akuzuari SH.B, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit së tij av.Fitim Shabani, nuk kam çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.M, avokati Kushtrim Obrazhda në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të njëjtën të elaboruar gojarisht në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se për tu konsideruar se është konsumuar vepra penale e shpërlarjes së parave, duhet të ekzistoj dashja si element qenësor i kësaj vepre si dhe të ketë njohuri lidhur me fitimin apo prejardhjen e parave nga ndonjë aktivitet kriminal, rrethana këto të cilat i akuzuari A.. nuk i ka ditur dhe as nuk ka mundur t'i dijë ngase shërbimet të cilat ia ka ofruar të akuzuarit Sh. kanë qenë vetëm mbi bazën e shoqërisë të cilën e kishin mes vete. Po ashtu është vërtetuar se i akuzuari A.. as që ka tentuar t'i fshehë apo maskoj paratë e të pandehurit Sh.. përkundrazi të njëjtat i ka deponuar në xhirollogarinë e tij bankare dhe deponimi i parave në bankë nuk ka për qëllim fshehjen e parave nga ndonjë aktivitet kriminal. I akuzuari A... këto shërbime i ka ofruar vetëm me arsyetimin se i akuzuari Sh..kishte kredi dhe po t i depononte në llogarinë e tij, banka do t ia merrte paratë nga llogaria. Andaj i propozon gjykatës që konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së të akuzuarin A.M ta liron nga akuza apo të bëhet rikualifikimi i veprës penale pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale me të cilat ngarkohet sipas aktakuzës.

I akuzuari A.M, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit së tij av.Kushtim Obrazhda, nuk kam çka të shtoj tjetër.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, gjykata për vërtetimin e gjendjeve faktike, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar këto prova:

Ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve: H. B, I.H, E.H, B.F, E.S, A.Rr, A.P,

Leximin e deklaratës së të dëshmitarit L.K, të dhënë me datën 14.05.2019, me datën 24.10.2018, në Stacionin Policor në Ferizaj.

Leximin e provave materiale, siç janë :

Transkripta në mes të akuzuarit SH.H, i cili përdor telefonin me numër 045/936-963 dhe të akuzuarit P.H, që përdor telefonin me numër 045/638-880, të datës 17.06.2018;

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarit B.B, i cili përdor telefonin me numër 044/105-535 dhe personit NN, i cili përdor telefonin me numër 044/264-372, të datës 18.06.2018;

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarit P.H dhe personit me emrin G., i cili përdor telefonin me numër 045/662-381, të datës 19.06.2018;

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarit SH.H, i cili përdor telefonin me numër 045/936-963 dhe të akuzuarit F.H, i cili përdor telefonin me numër 044/995-400, të datës 19.06.2018, 5)

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H. nga data 14.09.2018-28.09.2018;

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B SH.H, P. H, nga data 30.08.2018-13.09.2018;

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H, nga data 15.08.2018, 29.08.2018,

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 31.07.2018-15.07.2018,

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 01.06.2018-15.06.2018,

Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 16.06.2018-30.06.2018,

Trasnskripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 15.07.2018-31.07.2018,

Trasnskripta e bisedave në mes të akuzuarve SH.H dhe personave të tjerë të dyshuar nga data 17.05.2018-31.05.2018,

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarve SH.H, P.H, të datës 19.07.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, të datës 20.07.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H B.B, të datës 24.07.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.B, të datës 27.07.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, të datës 30.07.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.B dhe F.H, të datës 01.08.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit F.H, të datës 16.08.2018,

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, të datës 05.10.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit B.J, B.B dhe F.H, të datës 06.10.2018;

Raportet e vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.J, B.B dhe F.H, të datës 07.10.2018;

Raportet mbi marrjen e përkohshme të sendeve, me numër 2018-DHTN-896, të datës 07.10.2016, tek i akuzuari B.B,

Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve, me numër 2017-DHTN, të datës 07.08.2018, 2017-DHTN-896, të datës 07.10.2018, 2018-DHTN-896, të datës 07.10.2018 tek i akuzuari F.H;

Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve me numër 2017-DHTN-896, të datës 07.08.2018, tek i akuzuari SH.H, P.H dhe F.H;

Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve me numër 2017-DHTN-896, të datës 07.08.2018, tek i akuzuari SH.H;

Raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me numër AFK/2018-3053/2018-3011, të datës 22.01.2019,

Lexohet vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjëseneve me numër 2017-DHTN-896, të datës 07.08.2018, tek i akuzuari P.H;

Të dhënat financiare për të akuzuarin SH.H (nga NLB Bank), për të akuzuarin F.H (nga Pro Credit Bank), për të akuzuarin B.B (nga Pro Credit Bank), për të akuzuarin SH.B (nga Banka Ekonomike), për të akuzuarin A.M (nga NLB Bank),

Raporti përmbledhës i hetimeve financiare, i datës 28.01.2019, nga faqe 1- 47.

Kontrata e punës e datës 01.12.2011 e lidhur në mes të Sh.P.K “Al-Petrol” si punëdhënës dhe SH.H si i punësuar.

Ka dëgjuar mbrojtjen e të akuzuarve: SH.H, SH.I dhe SH.B.

Të akuzuarit F.H, B.B, A.H dhe A.M gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre ligjore janë mbrojtur në heshtje, nuk janë deklaruar gjatë fazës së mbrojtjes.

3.1 Deklaratat e dëshmitarëve

3.1.1 Dëshmitarja H.B, gjatë shqyrtimit gjyqësor fillimisht ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 25.10.2018, duke shtuar se e njëjta punon në arsim, me profesion edukatore, profesion të cilin e ushtron që 22 vite, po ashtu edhe bashkëshorti i saj punon në arsim. Me tutje ka shtuar se për shkak të martesës së vonshme, vëllezërit e saj ..dhe B.B të cilët jetojnë në botën e jashtme, i kishin bërë dhuratë shumë e parave në vlerë prej 10,000.00 €, me qëllim që e njëjta me ato para të blinte një veturë, e cila me pas në Shtator të vitit 2017 kishte blerë veturën Audi A4 në Prishtinë, në vlerë prej 9.200€, ku pagesën e veturës e ka bërë B.. mirëpo paratë ka theksuar se ia ka dhënë ajo pasi që kanë qenë të saj. Gjithashtu ka theksuar se vëllezërit e saj edhe më herët i kanë bërë dhurata prej ari, zingjir por jo me këtë vlerë, pasi që këto kanë qenë tri (3) motra dhe më tutje ka shtuar se përveç dhuratës vëllezërit nuk i kanë dërguar të holla pasi që e njëjta ka qenë në punë dhe ka pasur rrogën e saj. Më tutje ka deklaruar se me rastin e blerjes së veturës me të kanë qenë edhe bashkëshorti dhe vëllai i saj, i akuzuari B.B, i cili veturën e kishte regjistruar në emër të saj, dhe po ashtu serviset e veturës i kishte kryer i akuzuari B.B. Më pas të njëjtën veturë dëshmitarja ka deklaruar se e ka vozitur shumë pak, për arsye se e ka pas një veturë tjetër të tipit Golf 4 e cila ka qenë më praktike për vozitje dhe po ashtu nuk ka pasur hapësirë të mjaftueshme në oborrin e saj që ti lejë dy vetura,

sepse me kuletërit e saj kanë qenë në një oborr dhe se veturën Audi A4 e ka blerë për arsye se paratë ia kanë dhënë vëllezërit dhuratë për më ble veturë edhe pse kishte një veturë të tipit Golf 4, pastaj të njëjtën veturë e ka lënë tek prindërit e saj, përkatësisht vëllait të saj B.B, pasi që i njëjti nuk ka pasur veturë të tij dhe ai ka jetuar më prindërit të cilët ishin të sëmure dhe i ka pasur fëmijët e vegjël, dhe i njëjti në atë kohë ishte i pa punë.

3.1.2 Dëshmitarja I.H, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 01.02.2019, duke shtuar së të akuzuarit Sh.. dhe F.H i ka djem më të cilët jeton në bashkësi familjare, po ashtu ka edhe dy djem të tjerë B.H i cili prej 27 vite jeton në Z. dhe F.H i cili prej 7 vite jeton në Z., të cilët kanë firmë të pastrimit, ndërsa të akuzuarin B.B e ka vëlla. E njejtja ka shtuar se Sh.i ka kryer fakultetin dhe ka punuar në një pompë të benzinës këtu në Kosovë, por ndonjëherë ka shkuar edhe jashtë, ndërsa Flamuri ka punua në Zvicër një kohë, me vizë të punës të cilën ja kanë dërguar vëllezërit e tij. Më tutje dëshmitarja ka deklaruar se shoku i Sh., A.M të cilin më parë nuk e kishte njohur dhe ishte hera e parë që e kishte takuar, e kishte thirr në telefon 30 metra larg shtëpisë për të ia dhënë një shumë të parave në vlerë prej 5000€, e njejtja është takuar me A.. i cili i ka thënë merri këto para se të Sh.it janë së të vijnë, dëshmitarja i ka marrë paratë dhe është kthyer në shtëpi, dhe në kohën kur A... ia ka dorëzuar paratë dëshmitarës, SH.H ishte në paraburgim ndoshta që 2 apo 3 javë dhe kjo ishte arsyeja që paratë ia janë dorëzuar nënës së tij-dëshmitarës I.H e jo të akuzuarit SH.H, para të cilat e njejtja ka deklaruar se i ka shpenzuar më pastaj për pagesat e avokatëve dhe shpenzime të shtëpisë, duke shtuar se nuk e di se që sa kohë janë shokë i akuzuari A.M dhe djali i saj Sh.i, sepse ishte hera e parë dhe e vetme që e kishte takuar të njëjtin dhe prej tij nuk kishte pranuar ndonjë shumë tjetër të parave përveç shumës prej 5000€, për të cilat para dëshmitarja deklaroi se nuk e ka pyetur të akuzuarin A.M se ku i mori ato para që po ia sjellë Sh.it për arsye se ka menduar se ia kanë dërguar ndoshta vëllezërit por nuk është e sigurt se ku i ka marrë dhe shton se për këtë ndoshta më mirë e din vet Sh., dhe ka shtuar se e njejtja nuk ka qenë në dijeni se Sh.. këto të holla i ka pasur në xhirollogarinë e A. M. Dëshmitarja ka deklaruar se djemtë e saj F... dhe Sh.. nuk i kishte dëgjuar ndonjëherë që të bënin muhabet për ndonjë tregëti të ndaluar përveç muhabetëve familjare, më tutje ka shtuar se F... zakonisht ka qëndruar në shtëpi edhe ka ndodhur rrallë që të mos vie në shtëpi, ndërsa Sh...ka pasur raste që nuk ka ardhur në shtëpi edhe kur ka munguar nuk është që na ka treguar se ku është mirëpo më vonë nga policia e kemi kuptuar që ai e kishte marrë një banesë me qera. Ndërsa dëshmitarja ka deklaruar se për djemtë të cilët i ka në Zvicërr, zakonisht ata në Kosovë kanë ardhur 3 ose 4 herë në vit, dhe sa herë që kanë ardhur na kanë lënë të holla në vlerë prej 1000€, 2000€, 3000€, 4000€, por edhe shuma deri në vlerë 10,000.00 € varësisht se si kanë pasur mundësi. Më tutje ka shtuar se kemi paluajtshmëri – toka, ku njërin prej tokave e kanë shitur, vlera e së cilës ka qenë 37,000.00€, sipërfaqja e të cilës nuk i kujtohet, dhe ka shtuar se të gjërat në lidhje me tokën i ka kryer burri i saj dhe se me ato para kanë rregulluar shtëpinë, dhe e sa i kujtohet asaj me ato para edhe Sh.i e ka blerë veturën, dhe më tutje ka shtuar se bashkëshorti i saj ka pasur një xhirollogari në të cilën ka pas autorizim Sh... që me tërhek para. Po ashtu ka deklaruar se në vitin 2018 është e vërtetë që kanë pasur një veturë marka dhe ngjyra e të cilës nuk i kujtohet se ka kaluar kohë e gjatë, mirëpo vetura ka qenë e Sh.. të cilën e ka blerë me paratë që ja kanë dërguar vëllezërit nga jashtë, ndërsa ka shtuar se F...nuk ka pasur veturë në vitin 2018, pasi që e ka shitur veturën në atë kohë. Ndërsa paratë që djemtë i kanë sjellë kur kanë ardhur, dëshmitarja ka deklaruar se më janë dhënë mua dhe burrit, sepse ne kemi menaxhuar me to, por edhe djemve të tjerë pasi që i kanë pasur vëllezër dhe

ndonjëherë edhe atyre ju kanë dhënë para e edhe sot ju bijnë por më shumë më lënë mua dhe burrit. Dëshmitarja ka deklaruar po ashtu, se djemtë e saj Sh... dhe F...në momentin e arrestimit kanë qenë në banesë, dhe ka shtuar se shokun e tyre SH.B nuk e ka njohur dhe nuk ka qenë në dijeni që Sh.. ka pasur mjete të deponuara në llogarinë e tij.

3.1.3 Dëshmitari E.H, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 18.10.2018, mirëpo ka deklaruar se nuk më kujtohet saktësisht pa m'u lexuar deklarata se cka kam deklaruar atëherë. Më tutje ka shtuar se ka qenë përdorues i marihuanës dhe substancave narkotike të cilat i ka blerë nga P.H, por jo edhe nga të akuzuarit tjerë që janë prezent në sallën e gjykimit, po ashtu ka deklaruar se edhe ka shitur substanca narkotike. Dëshmitari në pyetjen e prokurorit se *“se nga kush keni blerë kokainën, sepse përgjigja e juaj që keni dhënë në polici ka qenë prej P.H dhe SH.H”* dëshmitari ka deklaruar se; *po me kujtohet por, ngase unë atëherë kam thënë se drogën e kam blerë vetëm nga P.H por oficeri që më ka marrë në pyetje G.H më ka shty që të them se e kam blerë edhe nga Sh.. ngase unë atëherë nuk e kam blerë nga SH.H kokainën”*. Dëshmitari më tutje përsëri ka theksuar se kokainën e ka blerë vetëm nga P.. dhe nuk ka pasur persona të tjerë kur është takuar me të, dhe zakonisht me P.. janë takuar në fitnes prej kur edhe e ka marrë vesh që P.. po shet drogë dhe gjatë bisedës më të njëjtin dëshmitari deklaroi se i kam kërkuar P.. që të më shet bari, mirëpo P.. i ka thënë që nuk shet bari por vetëm drogë, dhe dëshmitari më tutje ka deklaruar se është përdorues i të gjitha drogave dhe se kokainën e ka blerë nga Pa... dhe zakonisht kanë kontaktuar përmes telefonit dhe ka shtuar se numrat e telefonit 044 308 722 dhe 044 823 008 nuk i kujtohen. Ndërsa sa i përket deklaratës së dhënë në polici se ai është takuar me Sh.in së paku ndoshta 10 herë, i njëjti ka deklaruar se oficeri G.H.i i ka thënë së sa herë je takuar me Shp..5 apo 6 herë dhe dëshmitari është përgjigjur se jo asnjëherë dhe më pastaj oficeri sipas dëshmitarit i ka thënë se pse po rren dhe i ka sjellë (rrahur), dhe më tutje shton se gjatë intervistimit në polici kanë qenë dy persona mirëpo më shumë i ka bërë presion oficeri G.H, i cili e ka marrë në pyetje edhe herave të tjera për vepra të tjera penale, për të cilët nuk e ka lajmëruar rastin se nuk ka dit se ku të shkojë, më tutje shton se në stacion policor është takuar me oficerin G.H dhe se gjatë intervistimit janë ndërruar policët dhe nuk i kujtohet nëse kanë qenë oficerët V.G dhe H.F, dhe më pastaj shton se nuk i kujtohet nëse ka qenë oficeri G.H gjatë marrjes në pyetje, dhe shton se nënshkrimi në deklaratën e dhënë në polici është i tij dhe se nuk ka pasur qare pa deklaruar ashtu pasi që ia kanë prurë punën me deklaruar ashtu. Dëshmitari gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar se drogën kur e ka blerë e kanë marrë në llastik dhe në sasi 03, 02 mg dhe kryesisht e kanë blerë tek një rrugë e pazarit në Ferizaj afër fitnesit, por edhe në fitnes dhe kryesisht kohën kur e ka blerë drogën ka qenë pothuajse në gjithë vaktet, në mëngjes, në drekë e darkë m'varet, dhe zakonisht personi prej të cilit e kam blerë kokainën e ka mbajtur në xhep dhe kryesisht jemi takuar tek “Mehana” në Ferizaj. Dëshmitari më tutje ka deklaruar se të akuzuarin F.H nuk e njeh dhe asnjëherë nuk është takuar me të, po ashtu as të akuzuarin B.J nuk e njeh dhe ka shtuar se me E.S ka ndodhë që i kanë bërë paratë bashkë për me blerë 03 mg kokainë nga Sh.. dhe P... dhe e kanë pirë bashkë, mirëpo më tutje ka shtuar se kokainën e ka blerë vetëm nga P.. e jo edhe nga Sh.. duke theksuar se shuma për 03 mg kokainë ka qenë 25 euro, dhe se përveç kokainës ka blerë edhe narkotikë të tjerë si marihuanë, mirëpo jo prej P...por prej personave të tjerë si në Prishtinë, Ferizaj e edhe në Shqipëri dhe e ka blerë prej një personave me emrin C., R..dhe J... Dëshmitari ka deklaruar se nuk i kujtohet se ka njohur në atë kohë të akuzuarin SH.H, por mund të jetë e mundur që ndoshta ka biseduar më te në telefon kur e ka thirrur të akuzuarin P.H e ai nuk ka qenë aty e është

lajmëruar pastaj i akuzuari SH.H, dhe deklaroi se tani e njeh të akuzuarin mirëpo në atë kohë nuk e ka njohur, po ashtu nuk i ka njohur as të akuzuarit SH.I dhe B.B dhe prej tyre nuk ka blerë drogë ndonjëherë. I njëjti po ashtu ka shtuar se prej 9 vite është përdorues i narkotikëve dhe shuma e parave që ka shpenzuar për narkotikë ka qenë prej 1€ deri në 1000€ ngase ka blerë edhe me kg, dhe paratë për blerjen e kokainës i'a ka dhënë P.. ngase kokainën e ka blerë vetëm nga ai e jo edhe nga personat e tjerë.

3.1.4. Dëshmitarja B.F, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 30.10.2018, duke shtuar se gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë përdoruese e substancave narkotike dhe se për blerjen e marihuanës dhe kokainës zakonisht ka komunikuar në telefon me Fl.. për sigurimin e saj, mirëpo është takuar me Sh.. ose Pa.. dhe e ka blerë prej tyre. Më tutje ka shtuar se për Sh.in e kanë ditë të gjithë se shet drogë dhe prej tij e ka ble por fillimisht atë nuk e ka njohur pasi që për sigurimin e drogës ka bisedua me Flamurin por që pastaj drogën ia kanë sjellë Sh....ose P...dhe atyre ua ka bërë pagesën. Më tutje shton se i kujtohet një rast kur e ka thirr në telefon F.. dhe e kanë lënë me u taku tek nënkalimi në Ferizaj, dhe më pastaj kishte ardhur P..nga i cili kishte blerë 03 gram kokainë dhe ajo i kishte bërë pagesën pre 30 euro. Dëshmitarja deklaroi se me Sh.. është takuar ndoshta 5-6 herë nga i cili ka blerë narkotik, ndërsa me F.. ka biseduar në telefon për sigurimin e substancave narkotike mirëpo direkt prej F.. nuk ka blerë asnjëherë, dhe shton se F.. që nga viti 2018 nuk e ka takuar më, ndërsa para vitit 2018 nuk i kujtohet saktë se në cilin vit e ka njohur. Dëshmitarja më tutje ka shtuar se të akuzuarit SH.H dhe F.H i njeh, ndërsa të akuzuarin SH.I si figurë e njeh mirëpo nuk ka pasur kontakt ndonjëherë me të dhe nuk ka blerë narkotik ndonjëherë nga ky person, dhe po ashtu të akuzuarit B.B dhe A.H nuk i njeh.

3.1.5. Dëshmitari E.S, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 16.10.2018, duke shtuar se i njëjti është përdorues i substancave narkotike dhe se zakonisht substancat narkotike –kokainë i ka blerë në qese të vogël në shumë prej 20-30 euro për më pak se një gram kokainë, nga P.. të cilin e ka njohur përmes shokut të tij E. H dhe më pastaj e ka kuptuar se është djali i mixhës së SH.Ht, dhe se prej tij e ka kuptuar se këta shesin substanca narkotike, ndërsa nga Sh.. rrallë herë ka blerë, një ose dy herë kokainë ngase e ka pasur shok dhe me të janë takuar për të pirë kafe në kafiterin “Empire” dhe te “Mehana”, ndërsa të akuzuarin F.H nuk e ka njohur si figurë por vetëm nga emri, por nuk ka blerë asnjëherë substanca narkotike nga ai dhe nuk ka komunikuar asnjëherë përmes telefonit e as nuk është takuar asnjëherë me të. Dëshmitari më tutje ka deklaruar se SH.H në atë kohë sa i kujtohet ka qenë duke punuar në një pompë të benzinës dhe se ka pasur një veturë BMW, ndërsa të akuzuarit B.B, SH.I, A.H, SH.B dhe A.M nuk i njeh.

3.1.6. Dëshmitari A.Rr, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 10.10.2018, duke vazhduar se i akuzuari B.J ka shkuar në kompani për të marrë me qira një veturë për dy ditë dhe pastaj pasi ta kthen veturën të i'a bëjë pagesën, dhe vetura nuk është kthyer dhe pagesa nuk është kryer dhe i njëjti me atë vetura ka shkuar për në Shqipëri, dhe ka shtuar se i njëjti edhe më herët e ka marrë veturë me qira në kompani.

3.1.7. Dëshmitari A. P., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në deklaratën e dhënë në polici me datë 26.10.2018, është ftuar në polici dhe nuk i kujtohet se është pyetur diçka ngase policia sipas tij vetëm i kanë thënë nënshkruaje këtë deklaratë dhe shko dhe nuk i kujtohet se kush kanë qenë oficerët policorë. Më tutje dëshmitari ka deklaruar se të akuzuarin B.B e njëh ngase të njëjtit ia ka shitur një veturë Golf 4 dhe prej atëherë e njëh se dëshironte me ndërrua edhe veturën e tij Audi, duke shtuar se punon me ashensorë dhe merr vetura për kompensimin e punës së kryer. Më tutje dëshmitari deklaron se përkundër deklaratës së dhënë në polici, në pyetjen se; “*a keni përdorur ndonjë drogë dhe nëse po çfarë lloji keni përdorur, i njëjti ka deklaruar se; “Po dhe ka përdorur vetëm kokainë dhe asnjë lloj tjetër, dhe se të njëjtën e blen nga B.B”*”, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk është e vërtetë se nuk ka blerë ndonjëherë kokainë as nuk e ka përdorur dhe as që merret me atë punë. Dëshmitari më tutje deklaron se nga Stambolli në Kosovë ka ardhur në klasën e dytë të shkollës fillore dhe ka të kryer shkollën e mesme ekonomike dhe se nga të akuzuarit që gjendeshin në sallën e gjykimit nuk e njihje askënd dhe se në polici është deklaruar vetëm për pjesën e veturave dhe përkundër deklaratës së dhënë në polici se i njëjti është takuar me B.B në restorant “Niti”, “Parku” te “Viva Fresh Store”, përballë stacionit policor në F.. ku ai ka qenë me veturën e tij Pasat dhe B.. ka hyrë në veturën e tij dhe ia ka dhënë kokainën dhe ky ia ka dhënë paratë, i njëjti këtë deklaratë e mohon në dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësor dhe thekson se ai kurrë nuk ka fol për kokainë por kinse B.. ka hyrë me këqyr kerrin sipas tij, ngase donte me ndërrua veturën e tij të tipit Audi.

3.2. Deklaratat e dëshmitarëve që janë lexuar në shqyrtimin gjyqësor⁵

3.2.1 Dëshmitari L.K., në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-Stacionin Policor në Ferizaj me datën 24.10.2018, ka theksuar fillimisht se është përdorues i substancave narkotike marihuanë dhe kokainë që nga viti 2009, duke shtuar se kokainën e ka blerë nga të akuzuarit SH.H të cilin e ka njohur që nga viti 2009 si “diller” të kokainës, dhe nga P.H të cilin e ka njohur para 5 viteve ngase i njëjti kishte blerë marihuanë nga ai, dhe më të ka kontaktuar në numrin e telefonit 044 308 722 dhe është takuar zakonisht tek nënkalimi për blerjen e kokainës, ndërsa tw akuzuarin F.H vetëm e ka ditur që është vëllai i të akuzuarit SH.H, por me të nuk është takuar asnjëherë. Më tutje ka shtuar se kokainën që e ka blerë nga Sh.. përveq që janë taku tek nënkalimi, shumë shpesh edhe ka shkuar edhe kudo ku ka qenë SH.. ngase çdo herë ka pasur kokainë me vete të cilën e ka mbajtur në veturë, ka deklaruar se vetura ka qenë njëra e tipit BMW 1 ngjyrë e kaltërt, ndërsa tjetra BMW 320 ngjyrë hiri, por ka shtuar se ka pasur raste që Sh...dhe P....kokainën kur ka dashur ta blejë i njëjti, ja kanë dërguar edhe në këmbë, varësisht prej vendit ku e kanë lënë me u taku, dhe se këtë sasi të kokainës e kanë mbajtur në dorë. Më tutje ka shtuar

⁵ Trupi gjykues, sipas propozimit prokurorit shtetit si dhe pajtimin e të gjitha palëve, duke u bazuar në nenin 338 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka vendosur që të lexohen procesverbali mbi marrjen në pyetje dëshmitarëve të cilët i kanë dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj, për shkak se dëgjimi i tyre ka qenë i pamundur në shqyrtimin gjyqësor për shkak disa rrethanave dhe atë: për shkak se dëshmitari Lumbardh Kashtanjeva i është dërguar ftesa për të marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo nga fletëkthesa e kthyer është konstatuar se i njëjti është shpërngulur nga kjo adresë, për çka gjykata ka lëshuar urdhëresën për dorëzimin e thirrjes, mirëpo nga Stacioni Policor në Ferizaj, gjykata është i njëjti nuk gjendet në shtëpi. Ndërsa për dëshmitarin Bashkim Arifi gjykata nga Stacioni Policor në Ferizaj ishte njoftuar se i njëjti gjendet jashtë Kosovës, përkatësisht në Sllovaki. Prandaj trupi gjykues ka marr aktvendimin të cilin ka aprovuar këtë propozim dhe ka bërë leximin e deklaratave të dëshmitarëve të cilët janë cekur në këtë pjesë të Aktgjykimit.

se më shpesh ka blerë kokainë nga Sh.i në sasi prej 0.3 dhe 0.5, ndërsa nga P...ka blerë më rrallë por edhe nga ai ka blerë 0.3 dhe 0.5 por ka pasur raste që ka blerë edhe 2 gram.

3.2.2 Dëshmitari B..A në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës-Stacionin Policor në Ferizaj me datën 31.10.2018 ka theksuar se me të akuzuarin F.Hn ka pasur raporte fqinjësore dhe me të njejtin janë takuar shpesh për të pirë kafe por jo edhe për ndonjë arsye tjetër dhe shpesh herë ka shkuar edhe në shtëpinë e tij, po ashtu kanë shkuar edhe në Prishtinë së bashku, ndërsa me të akuzuarin SH.H dhe P.H është takuar rrallë dhe kryesisht afër shtëpisë së tyre. Më tutje ka shtuar se nuk e ka ditur se me çfarë është marrë F.H, ka ndodhë që edhe i ka marrë shpesh herë edhe para borgj të njejtit në shumën deri 100 euro, por më pastaj ia ka kthyer. Ndërsa sa i përket veturës së tipit Audi A4 me targa të regjistrimit 05-449-DP, ka theksuar se ka qenë e regjistruar në emrin e tij për shkak se i akuzuari SH.H e ka pasur një veturë në emrin e tij, dhe kjo veturë nuk ka mundur të regjistrohet në emër të F.Ht pasi që i njejtë në atë kohë ishte në burg dhe ka shtuar se ka pranuar që kjo veturë të regjistrohet në emër të tij për shkak të fqinjësisë që kishin, mirëpo shpenzimet rreth regjistrimit të kësaj veture, vlera e së cilës ka qenë 9000 euro, i ka mbuluar SH.H.

3.3 Provat materiale

- 3.3.1** Nga leximi i transkriptit në mes të akuzuarit SH.H, i cili kishte përdorur telefonin me numër 045/936-963 dhe të akuzuarit P.H, që kishte përdorur telefonin me numër 045/638-880, të datës 17.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se në këtë transkript shihet biseda në mes dy të akuzuarve të lartpërmendur nga e cila kuptohet bashkëpunimi ndërmjet tyre për shitjen e drogës, sepse nga kjo bisedë shihet se i akuzuari Sh. e porositë të akuzuarin P.. që ta dërgojë një sasi të drogës në vlerë prej 50 Euro, një personi në qytetin e Ferizajit.
- 3.3.2** Nga leximi i transkriptit të bisedave në mes të akuzuarit B.B, i cili kishte përdorur telefonin me numër 044/105-535 dhe personit N.N, i cili kishte përdorur telefonin me numër 044/264-372, të datës 18.06.2018, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari B...ishte takuar me një person NN, në qytetin e Obiliqit me të cilin ishin takuar edhe me parë.
- 3.3.3** Nga leximi i Transkriptit të bisedave në mes të akuzuarit P.H dhe personit me emrin G..., i cili përdor telefonin me numër 045/662-381, të datës 19.06.20218, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari P.... kishte biseduar me këtë person i cili kishte qenë konsumues i drogë.
- 3.3.4** Nga leximi i transkriptit të bisedave në mes të akuzuarit SH.H, i cili kishte përdorur telefonin me numër 045/936-963 dhe të akuzuarit F.H, i cili kishte përdorur telefonin me numër 044/995-400, të datës 19.06.2018, nga këto biseda vërtetohet se të dy bashkëpunojnë lidhur me shitblerjen e narkotikëve sepse F...ka pasur një blerës dhe në vendin që e mbajnë substancën narkotike nuk ka pas sepse Sh.i i ka marrë me të gjitha me qëllim të shitjes. F..e pyet Sh.in nëse ka 3 Euro (pra përdorë shifrën 3 Euro për 3 gram drogë) dhe pasi që ky i thotë se kam, F... i thotë që të vjen te shpija se është duke pritë dikush.

- 3.3.5 Nga leximi i pesë (5) Transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 14.09.2018-28.09.2018 nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.
- 3.3.6 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B SH.H, P.H nga data 30.08.2018-13.09.2018, gjykata ka vërtetuar se me datën 30.08.2018, nga disa sms të shkëmbyer nga SH.H përmes numrit të telefonit 044 823 009, me dëshmitarin L. K në numrin e telefonit 045 620 287, vërtetohet se L. K kishte blerë dy paketime të narkotikut të llojit kokainë në shumën prej 50 euro. Po ashtu, nga transkriptet e të njëjtës datë të P.H i cili kishte komunikuar edhe P...me personat NN të cilët i kishin kërkuar një sasi të narkotikut të kokainës prej 30 euro, të cilët persona kuptohet se edhe më parë kishin blerë tek SH.H. Po ashtu nga transkriptuat e bisedave të datës 01.09.2018, të zhvilluar ndërmjet F.Ht me numër të telefonit 044 995 400, dhe dëshmitares B. F.me numrin e saj të telefonit si dhe të akuzuarit P. H., është vërtetuar bashkëpunimi ndërmjetë se dëshmitarja kishte blerë një sasi të kokainës, sipas bisedës B...fillimisht kontakton me F... i cili thotë se të shkojë tek nënkalimi se do ta dërgojë një djalë, pastaj F... kontakton me P....dhe i thotë se do të vjen B... tek nënkalimi, dhe i tregon lidhur me B...për sasinë e kërkuar. Pastaj P...e thërret dëshmitaren B.. dhe i thotë se M.... më tha me të thirr dhe me të cilën takohen dhe i shet narkotikun. Nga transkriptat e bisedave të datës 02.09.2018, 03.09.2018 dhe 04.09.2018, nga këto biseda vërtetohet se P.H dhe SH.H ju shesin personave të ndryshëm NN sasi të narkotikut, po ashtu nga biseda e datës 04.09.2018, në mes të F.Ht dhe P.H shihet komunikimi në mes të dy të akuzuarve që F.. e porositi që të dal poshtë se është duke ardhur një blerës dhe përdor shifrën si 4 që ka qenë për shumën e narkotikut dhe që pastaj F.. i thotë të akuzuarit P..se prit se po të shkruaj në ssnap, pra nga kjo vërtetohet bashkëpunimi në mes të F.. dhe Pa.. për shitjen e narkotikut. Po ashtu, nga transkriptat e bisedave të datave; 05.09.2018, 06.09.2018, 07.09.2018, 09.09.2018, 10.09.2018, 11.09.2018, 13.09.2018, shihet komunikimi i P.H, SH.Ht me personat NN që kishin blerë narkotik prej tyre, por shihet edhe komunikimi që kishte SH.Ht me F.Ht në lidhje me blerjen e narkotikut që kishte bërë dëshmitari L. K me datën 07.09.2018.
- 3.3.7 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 15.08.2018, 29.08.2018, nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.
- 3.3.8 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 31.07.2018-15.07.2018, nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.

- 3.3.9 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 01.06.2018-15.06.2018, nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.
- 3.3.10 Transkripta e bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 16.06.2018-30.06.2018, nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.
- 3.3.11 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve F.H, B.B, SH.H dhe P.H nga data 15.07.2018-31.07.2018, nga këto transkriptet të bisedave vërtetohet bashkëpunimi në mes të akuzuarve lidhur me shitblerjen e narkotikut të cilët gjatë bisedave të tyre përdorin shifra të ndryshme si gjatë komunikimeve në mes veti por edhe me persona të ndryshëm me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së narkotikut.
- 3.3.12 Nga leximi i transkriptave të bisedave në mes të akuzuarve SH.H dhe personave të tjerë të dyshuar nga data 17.05.2018-31.05.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se në këto transkripte shihen bisedat që kishte zhvilluar i akuzuari SH.H me persona të ndryshëm lidhur me shitblerjen e drogës, ashtu që me datën 22.05.2018, kishte biseduar me vëllain e tij F.H i cili ishte nën masën e paraburgimit, e që biseda ishte zhvilluar rreth lëndëve narkotike të cilat i kishte në posedim i akuzuari Sh.. për ti shitur. Po ashtu me datën 23.05.2018 shihet biseda që kishte zhvilluar SH.H në mes të personave NN të cilët i kishte furnizuar me substanca narkotike të llojit kokainë. Po ashtu nga transkriptimi i datën 24.05.2018, shihet se personi NN fillimisht i kishte shkruar sms për tu takuar dhe pastaj e kishte thirr në telefon të akuzuarin Sh. që ishte në spital për ta vizituar një shok të tij e që ishte M...A e që ishte në vuajtje të dënimit me burgim në Burgun e Dubravës, dhe se qëllimi i takimit ishte furnizimi me narkotik. Po ashtu nga biseda e datës 30.05.2018, kuptohet që i akuzuari Sh. ishte takuar me persona NN për furnizim të tyre me substanca narkotike e që nga biseda kuptohet se takimi me këta persona ishte në koordinim edhe me të akuzuarin B.B
- 3.3.13 Nga leximi i Raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarve SH.H, P.H, të datës 19.07.2018, vërtetohet se të akuzuarit e lartpërmendur ishin përcjell nga ana e zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit, ku të njëjtit takohen me persona të ndryshëm.
- 3.3.14 Nga leximi i Raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarve SH.H, P.H, të datës 20.07.2018, vërtetohet se i akuzuari P.. ishin përcjell nga ana e zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit, ku të njëjtit takohen me persona të ndryshëm.
- 3.3.15 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.B, të datës 24.07.2018, vërtetohet se të akuzuarit Sh..dhe P.H ishin përcjellë nga ana e

zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit, ku të njëjtit takohen me persona të ndryshëm.

- 3.3.16 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.B, të datës 27.07.2018, vërtetohet se të akuzuarit SH.H, P.H dhe B.B, ishin përcjellë nga ana e zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit, ku të njëjtit takohen me persona të ndryshëm.
- 3.3.17 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, të datës 30.07.2018, vërtetohet se të akuzuarit SH.H, P.H dhe, ishin përcjellë nga ana e zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit, ku të njëjtit takohen me persona të ndryshëm, të cilët kanë qenë blerës të narkotikut, çka vërtetohet se të akuzuarit kishin bërë shitjen dhe shpërndarjen e narkotikut në rrugët që janë cekur në këtë raport.
- 3.3.18 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.B dhe F.H, të datës 01.08.2018, vërtetohet se të akuzuarit SH.H, P.H dhe B.B dhe F.H, ishin takuar në restorantin e “Hib Petrol” në Ferizaj përballë Stacionit Policor, dhe pastaj kishin vazhduar në drejtime të ndryshme. Dhe po ashtu shihet se B.B atë ditë kishte shkuar në banesën e të akuzuarit SH.Ht në rrugën “..”. Po ashtu shihet takimi i të akuzuarit SH.H me persona të ndryshëm në afërsi të banesës së tij.
- 3.3.19 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit F.H, të datës 16.08.2018, vërtetohet se i akuzuari F.H ishte përcjellë nga ana e zyrtarëve policor, i cili shihet me dy persona të tjerë të ulur ne hapsirat e restorantit “trofta” në dalje të fshatit Firajë, Komuna e Shterpës, ku i akuzuari shihet me dy persona duke ngrenë darkë dhe pas përfundimit të darkës kthehet rrugës për Ferizaj.
- 3.3.20 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, të datës 05.10.2018, vërtetohet se të akuzuarit Sh.. dhe P.H ishte përcjellë nga ana e zyrtarëve policor në rrugët e qytetit të Ferizajit dhe në fshatin Prelez i Jerlive, ku shihen duke hyrë në shtëpitë e tyre në këtë fshat dhe shihet se P.. kishte dal në këmbë nga shtëpia dhe kishte vazhduar rrugës kryesore dhe tek nënkalimi shkon te Qendra Tregtare “Liridoni”, takohet me një person me motoçikletë dhe i jep diçka.
- 3.3.21 Nga leximi i raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit B.J, B.B dhe F.H, të datës 06.10.2018, vërtetohet se të akuzuarit B.B dhe F.H ishin përcjellë nga ana e zyrtarëve policor, të cilët shihen se së bashku kanë kaluar pikën kufitare në Vermicë me veturën Audi A4 me targa të regjistrimit .. ngjyrë e zezë, dhe me këtë veturë kanë kaluar në territorin e Shqipërisë. Po ashtu në këtë raport shihet se në të njëjtën ditë ishte përcjellë edhe i akuzuari B.J në rrugën kryesore Ferizaj – Kaqanikë dhe në drejtim të fshatit Stagovë.
- 3.3.22 Nga leximi i Raportit të vëzhgimit – monitorimit për të akuzuarit SH.H, P.H, B.J, B.B dhe F.H, të datës 07.10.2018, vërtetohet se të akuzuarit SH.H, P.H dhe B.B dhe F.H,

B.J, me këtë datë prej orës 12:00/h, ishin nën monitorim dhe vëzhgim nga ana e zyrtarëve policor në qytetin e Ferizajit-Kaqanikut si dhe në pikën kufitare Vërmicë në cilën pikë i akuzuari B.J vetëm kishe kaluar pikën kufitare Vërmicë. Rreth orës 20:15 ishte lokalizuar i akuzuari B.J në pikën kufitare Vërmicë i cili po vinte nga territori i Shqipërisë, me veturën e tipit Audi A4 me targa 662-KS-039. Gjatë kontrollit në trupin e tij është gjetur substanca narkotike kokainë dhe i njëjti është arrestuar. Po ashtu në dy lokacionet tjera në fshatin Prelez – Ferizaj në shtëpinë e të dyshuarve si dhe në lokacionin në banesë në rrugën “Nazmi Uksmajli” kishin intervenuar NJRSH duke i bastisur këto lokacione ku janë arrestuar edhe të akuzuarit tjerë.

- 3.3.23 Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, me numër 2018-DHTN-896, të datës 07.10.2016, tek i akuzuari B.B, gjykata ka vërtetuar se tek i njëjti në shtëpinë e tij në fshatin Stagovë, janë sekuestruar: një (1) revole e tipit Zastava M-57, e kalibrit 7.62 mm, me numër serik: H-99359, me një (1) karikatorë dhe nëntë (9) fishek të kalibrit 7.62 mm, një (1) revole e kalibrit 6.35 mm, me numër serik: 493788, me një (1) karikatorë dhe katër (4) fishek, dyzetënjë (41) fishek të kalibrit 7x64mm si dhe gjashtë (6) fishek të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12 mm, një peshore digjitale ngjyrë të kaltër në të hirit, para në vlerë prej 860 €uro dhe 170 denar të Republikës së Maqedonisë.
- 3.3.24 Nga leximi i tre (3) vërtetimeve mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, të gjitha të datës 07.08.2018, me numër 2017-DHTN-896, tek i akuzuari F.H, gjykata ka vërtetuar se nga i njëjti në shtëpinë e tij në fshatin Prelez i Jerlive, Komuna e Ferizajit, janë sekuestruar: një (1) antiplumb ngjyrë të kaltër, një (1) telefon “Samsung” ngjyrë e zezë ku ishte numri i vendosur (044-995-400), dhe një (1) veturë e tipit “Audi”, ngjyrë e zezë me targa të regjistrimit 05-449-DP, së bashku me një qelës dhe Certifikatën e regjistrimit të automjetit të lartpërmendur.
- 3.3.25 Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, me numër 2017 DHTN – 896, të datës 07.08.2018, tek të akuzuarit SH.H, P.H dhe F.H, gjykata ka vërtetuar se në banesën e tyre në rrugën “..” në F.., janë gjetur dhe sekuestruar: para në shumë 3110 (tremijë e njëqind e dhjetë) €uro, 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) denar të Republikës së Maqedonisë, një (1) lirë Turke, një (1) qese najloni e dyshuar me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 0.5 gram, një (1) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 0.3 gram, një (1) fotroll ngjyrë e zezë e pistoletës, një (1) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 0.3 gram, një (1) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 57.2 gram, dy (2) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 0.9 gram, një (1) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 50.1 gram, një (1) peshore digjitale, një (1) telefon mobil “Samsung” i thyer ngjyrë e zezë, një (1) shah së bashku me figura të mbushura të cilat ishin dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit “Marihuanë”, një (1) qese najloni e cila ishte dyshuar se ishte me substancë narkotike të llojit kokainë në peshë prej 0.4 gram, 1 (një) lugë metalike e çajit, vizitkarta dhe dokumente të evidentuara si dëshmia.

- 3.3.26 Nga leximi i raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, me numër AFK/2018-3053/2018-3011, të datës 22.01.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se sipas karakteristikave të morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmitë # D1, 1.1, 2, 3, 7.1, 7.2, dhe 10 përmbajnë Kokainë, peshë neto të përgjithshme 551.44 ± 0.0001 gram. Po ashtu se sipas karakteristikave të morfologjike dhe përbërjes kimike është vërtetuar se dëshmitë D#9, përmban kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (TCH) peshë neto: 5.54 ± 0.0001 gram. Ndërsa sipas karakteristikave të morfologjike dhe përbërjes kimike është vërtetuar se dëshmitë D# 5 dhe 8, nuk përmbajnë asnjë narkotikë të rrezikshëm, substancë psikotope apo prekursorë peshë neto të përgjithshme 103.38 ± 0.0001 gram. Ndërsa sa i përket dëshmitëve D# 4 dhe 6 nuk përmbajnë material (mostër) për analizë.
- 3.3.27 Nga leximi i vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, me numër 2017-DHTN-896, të datës 07.08.2018 tek i akuzuari SH.H, gjykata ka vërtetuar faktin se nga i njëjti në shtëpinë e tij në fshatin .. i .., janë sekuestruar: një (1) telefon Iphone 7 plus, ngjyrë vjollce, IMEI:355733072355149, një (1) telefon Iphone 7 plus, ngjyrë e bardhë, një (1) telefon Iphone 5, ngjyrë Ari, me SIM kartelë 044-823-008 , IMEI:.. një (1) telefon Samsung Duos E0168, ngjyrë e bardhë, një (1) telefon Samsung G850F, ngjyrë e bardhë, IMEI:356010065945676.
- 3.3.28 Lexohet vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve me numër 2017-DHTN-896, të datës 07.08.2018, tek i akuzuari P.H, gjykata ka vërtetuar faktin se nga i njëjti në shtëpinë e tij në fshatin Prelez i Jerlive, Komuna e Ferizajit, janë sekuestruar: një (1) veturë e tipit “BMW”, me targa të regjistrimit 05-193-DM, së bashku me një qelës dhe Certifikatën e regjistrimit të automjetit i cili automjet evidentohet se ishte në emër të akuzuarit SH.H, si dhe një (1) telefon “Iphone IV”.
- 3.3.29 Nga leximi i të dhënave financiare për të akuzuarin SH.H (nga NLB Bank), gjykata ka vërtetuar se i akuzuari kishte hapur llogari bankare në këtë bankë ku mund të shihet qarkullimi bankar në llogarinë e të akuzuarit.
- 3.3.30 Nga leximi i të dhënave financiare për të akuzuarin F.H (nga Pro Credit Bank), gjykata ka vërtetuar se i akuzuari kishte hapur llogari bankare në këtë bankë ku mund të shihet qarkullimi bankar në llogarinë e të akuzuarit.
- 3.3.31 Nga leximi i të dhënave financiare për të akuzuarin B.B (nga Pro Credit Bank), gjykata ka vërtetuar se i akuzuari kishte hapur llogari bankare në këtë bankë ku mund të shihet qarkullimi bankar në llogarinë e të akuzuarit.
- 3.3.32 Nga leximi i të dhënave financiare për të akuzuarin SH.B (nga Banka Ekonomike), gjykata ka vërtetuar se i akuzuari kishte hapur llogari bankare në këtë bankë ku mund të shihet qarkullimi bankar në llogarinë e të akuzuarit.

- 3.3.33 Nga leximi i të dhënave financiare për të akuzuarin A.M (nga NLB Bank), gjykata ka vërtetuar se i akuzuari kishte hapur llogari bankare në këtë bankë ku mund të shihet qarkullimi bankar në llogarinë e të akuzuarit.
- 3.3.34 Nga leximi i Raportit përmbledhës i hetimeve financiare, me numër të referencës 2018-DHTN-SHFI-14-22/132, i datës 28.01.2019, nga faqe 1- 47 gjykata ka vërtetuar faktin se për të akuzuarit B.B, Sh., Fl.. dhe P.H, B.J, SH.B dhe A.M, është bërë hetim financiarë nga Njësia e Hetimeve të Integruara SHFI-DHKO, për të gjithë të akuzuarit të lartpërmendur bazuar në të dhënat e Institucioneve Financiare, të cilat veprojnë në Kosovë për periudhën e përcaktuar 01.01.2015-24.10.2018 sipas urdhëresës së Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, ashtu vërtetohen nga ky raport vërtetohen të gjitha qarkullimet që kanë pasur të akuzuarit për këtë periudhë kohore, qoftë ato Bankare, të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të Agjencionit të Regjistrimit të Bizensve (ARBK), të Administratës Tatimore të Kosovës, të Agjencisë së Regjistrimit Civil, të Agjencisë së Regjistrimit Civil-Drejtoriati për Regjistrimin e Automejete si dhe të Doganës së Kosovës.
- 3.3.35 Nga leximi i Kontratës së punës e datës 26.11.2014 e lidhur në mes të Sh.P.K “Al-Petrol” si punëdhënës dhe SH.Ht si i punësuar, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari SH.H, ishte punësuar në këtë kompani në detyrën: “Shitës në market” dhe si i punësuar kishte një pagë mujore në shumë prej 275 Euro.
- 3.3.36 Nga shikimi i aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me numër PKR.nr.164/2017, të datave 12.04.2018 dhe 08.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se nga gjykata e lartpërmendur të akuzuarit F.H me aktvendimin e datës 12.04.2018, ishte vazhduar paraburgimi në kohëzgjatje prej dy (2) muajve dhe atë prej datës 12.04.2018 deri me datën 11.06.2018, ndërsa me aktvendimin e datës 08.06.2018 ndaj të akuzuarit F.H ishte ndërprerë paraburgimi me datën 08.06.2018.
- 3.3.37 Nga shikimi i fotoalbumi të bërë nga njësia e forenzikes me numër 2018-DHTN-896, të datës 07.10.2018, gjykata konstaton se është bërë fotografimi i vendeve të ngjarjes dhe fotografit shihet substanca naroktiku e cila ishte gjetur në trupin e të akuzuarit B.J, e cila rezultuar të jetë e llojit “Kokainë”. Po ashtu shihet edhe nakortiku, paratë, armët, vetuarat dhe provat tjera të cilat janë gjetur, fotografuar dhe sekuestruar gjatë arrestimit të akuzuavre Sh..., P..., F.H dhe B.B, në banesë, përkatësisht në shtëpitë e tyre.

3.4 Mbrojtja e të akuzuarve

3.4.1. **I akuzuari SH.H**, në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk qëndron pranë deklaratës së datës 08.10.2018 të dhënë në polici për arsye se ka qenë nën presion pasi që një ditë përpara ka qenë i arrestuar. Ka qenë i punësuar në firmën “Al Petrol” afër dy vite, prej 2015 deri 2016, dhe ka punuar si shitës në market me pagë mujore 275 euro. Jeton me vëllain F.H, dy motra dhe dy prindërit në fshatin Prelez të Jerlive, Komuna Ferizaj, ndërsa dy vëllezër i

ka në Zvicër, përkatësisht vëllai B.H.jeton në Zvicër afër 30 vite me familje, dhe po ashtu është vëllai tjetër F.H.i cili jeton afër 10 vite në Zvicër edhe ky me familjen e tij, nga të cilët ka pranuar ndihma-të holla, e që zakonisht këto të holla i kanë sjellë me rastin e ardhjes në pushim në Kosovë, ose kur kanë ardhur vetë ose kur ka ardhur ndonjë person i afërt përkatësisht axhallarët të cilët i ka jashtë, shuma më e lartë ka mundur të jetë deri në 5000 euro. Saktë nuk e din sa shpesh ka pranuar para, por përafërsisht ndoshta 10 herë, këto para iu kanë dorëzuar prindërve, ka ndodhë që prindi nga ato mjete me na dhënë neve për ndonjë shërbim apo diçka. Prindi i tij ka qenë i punësuar në Zvicër afër 20 vite, dhe atë prej vitit 1970 deri 1990 dhe prej kësaj periudhe tanimë ka qenë i pa punë. Babai ka marrë pension në vitin 2011, dhe shuma e pensionit që ka përfituar babai ka qenë 44 mijë euro dhe vet i akuzuari ka qenë i autorizuar në ProCreditBank që të bëjë tërheqjen e të hollave dhe për këtë e kam sjellë edhe kopjen e autorizimit të bankës ProCreditBank dhe i akuzuari ia dorëzon gjykatës shkresën me titullin Zbatimi i kërkesës me informata nga palët e treta, e datës 06.11.2018, për Gjykatën Themelore në Ferizaj nga ProCreditBank dhe i akuzuari thekson se në këtë shkresë nuk është e cekur shuma por vetëm autorizimi që tregon se unë kam qenë i autorizuar. Në vitin 2013 kam shitur paluajtshmëri një personi me mbiemër Begaj, emri i të cilit nuk më kujtohet as shuma e saktë por çmimi ka qenë diku rreth 19 mijë e diçka. Po ashtu kam marrë dy herë kredi dhe atë nga ProCreditBank në vitin 2010 shumë prej 5000 euro dhe në vitin 2015 shumë prej 3900 euro. Në vitin 2015 kam blerë veturën BMË 318 me targa të regjistrimit 05 193 DM në shumë prej 2000 deri 2500 euro, me paratë e vëllezërve, të cilën në vitin 2018 ia kam shitur djalit të axhës P.Ht për shumë 2500 euro, e cila veturë është sekuestruar prej policisë, dhe veturën tjetër BMË 120 D, me targa të regjistrimit 05 677 EC që ka qenë në emër të Sh. .B ndërsa tani e kam pasur edhe një OPEL Vectra e cila ka qenë e motrës dhe atëherë ia kam dhënë edhe BMË dhe pastaj e kam marrë BMË 120 e cila e ka pasur vlerën prej 5000 euro, ngase e kam dhënë Opel Vectren dhe paratë prej 2500 euro nga shitja që ia kam bërë P.Ht. Automjetin BMË 120D e kam regjistruar në emër të Sh. B. për shkak se nuk kam mundur të regjistroj veturë në emrin tim për shkak se kam pasur obligime te fakulteti Iliria në Prishtinë, ashtu që fakulteti më ka dërguar tek përmbauesi dhe për këtë arsye ka qenë e konfiskuar edhe vetura BMË 318 05 193 DM që ka qenë në emër timin e të cilën ja kam shitur P.Ht dhe po ashtu për shkak se kam pasur dënime të trafikut dhe e patën bërë që me i shlye dënimet pastaj me regjistruar veturën. Ndërsa nuk ka deponuar asnjëherë mjete financiare në emër dhe llogari të A.M.. F.Hn e kam vëlla, i njëjti nga Shtatori i vitit 2017 deri me Qershor të vitit 2018 ka qenë i arrestuar për vrasje në tentativë dhe ka qenë në qendrën e paraburgimit në Gjilan. Para se të arrestohet ka pasur veturë të tipit Audi A4 ngjyrë të zezë, me targa .. por nuk ka qenë në emër të tij por në emër të pronarit prej të cilin e ka blerë. B.. B. e kam dajë, B.J është komshi i dajve, SH.In e kam njohur ngase e kam pasur shok të klasës, ndërsa nga data 16.05.2018 e deri 07.10.2018 kam bashkëpunuar vetëm me P.Hn duke bërë shitblerjen e narkotikut të llojit kokainë në Ferizaj, narkotikun e kemi siguruar në Shqipëri-Durrës, pagesën në formën kesh prej 800 euro për 20 gram kokainë ia kam paguar personit me emrin M., mbiemri nuk më kujtohet, i cili vet e ka sjellë deri tek shtëpia ime në fshatin .. dhe aty në shtëpi e kam paguar. Me M.. kam rënë në kontakt derisa isha në pushime verore në Shqipëri, pasi që vet kam qenë konsumues i drogës, përkatësisht kokainës dhe marihuanës. Një gram ka qenë 80 euro dhe përfitimi ka arritur deri në 200 euro, pra për nevoja personale kafe, naftë, kurr gjë tjetër. Brenda javës janë shitur 3 deri në 5 gram që përfitimi i bie deri në 300-400 euro në javë. Personalisht këtë veprimtari të shitjes së narkotikut e kam ushtruar në vitin 2018 deri kur jemi arrestuar. Me Pajtimin rolet i kemi pasur të barabarta, kur s'kam qenë unë ka dal P..u taku me klient, kur s'ka

qenë P.. kam dalë unë, d.m.th. fitimi ka qenë i përbashkët. A.M. e njoh prej shkollës fillore se kam qenë në klasë me të, dhe na ka mbet shoqëri por me të s'kam pasur kurrfarë bashkëpunimi. Kam pasur xhirollogari bankare personale në NLB Bank, në të cilën kam pasur qasje vetëm unë por asnjëherë nuk i kam dhënë para A.. që ai të deponojë apo që të kem deponuar ndonjëherë në llogari të tij dhe as nuk kam bartur mjete monetare në xhirollogari të ..A.. ,Sh.B e njoh përmes një shoku që ka pasur një kafiq ku ka punuar Sh..dhe atë lokal e kam frekuentuar dhe nga aty e njoh dhe jemi shoqëruar. Në xhirollogari të tij nuk kam transferuar para, por me qëllim të qarkullimit bankar të tij për shkak të vizës që ka pasur të marr Sh.., ia kam dhënë 7000 euro *cash*, të cilat kanë qenë prej kursimeve që më kanë dërguar vëllezërit dhe që i kam fituar nga shitblerja e veturave, ndërsa prej fitimit të narkotikut jo, ngase përfitimet rreth shitjeve kanë qenë të vogla dhe kanë qenë për nevoja personale. Pastaj Shk.. 2000 Euro mi ka kthyer para arrestimit ndërsa 5000 Euro ia ka kthyer nënës time pas arrestimit tim. Përpos këtyre 7000 eurove, edhe vetura BMË 120D ka qenë në emër të Sh.. dhe atë kam kërkuar unë që të regjistrohet në emër të tij për arsye të cekura më lartë, ngase kam pasur kredi, dënime, lëndë tek përmbarusi. Sh...nuk ka qenë në njohuri për shitblerjen e narkotikut. B.A. e kemi pasur komshi(fqinjë), kur është blerë vetura është bartur në emër të B.A përderisa F... ka qenë në paraburgim. E kam përdorur numrin i telefonit 044 .. derisa ka qenë F.. në paraburgim, por kur ka dal prej burgut edhe F..e ka përdor, ndërsa unë pastaj kohë pas kohe e kam përdorur këtë numër të telefonit. A.. e njoh, përmes M..A.i cili është në vuajtje të dënimit në burgun e Dubraves për vrasje dhe kur kam qenë në vizitë në burg tek M.., më ka treguar se e kam një shok që punon në mobilieri, pra për A.Hn, dhe i kam thënë se më duhet dikush që punon me mobilieri dhe ai më ka këshilluar që unë të shkoj te A.H dhe interesi ka qenë që ti bëjmë disa vrima në figurat e shahut për arsye që unë me fut marihuanën në figurat e shahut, për arsye me mbajt për veti dhe me fsheh. Pagesë nuk kam bërë, pasi që A..e ka pasur shok M.. dhe ai e ka thirr në telefon A.. dhe i ka thënë se vjen një shok pra e ka pasur fjalën për mua, dhe pastaj unë e kam thirr A.. dhe jam taku me të. Nuk më kujtohet data por me A... në fshatin G.. jam takuar kur ia kam dorëzuar figurat e shahut, dhe i kam kërkuar që të punoj disa vrima në ato figura por i njëjti nuk më ka pyetur për çka po më duhen pasi nuk e kam pasur shok. Qëllimi ka qenë për me fsheh narkotikun, por A..s'ka ditë çka po bëhet aty përveç që i ka bërë vrimat e figurave të shahut, ndërsa unë vet kam shkuar i kam marrë në fshatin G.. dhe unë vet i kam mbushur ato vrima me drogë. Këto figura të shahut gjatë bastisjes janë gjetur në banesë dhe kanë qenë të mbushura me marihuanë. Diku kah Pranvera e vitit 2018, kam pasur një banesë në Ferizaj me qira rreth 160 Euro, në të cilën kam jetuar vetëm, por kanë ardhur ndonjëherë .P... F.., Sh..dhe B..me të cilët kemi dalur kemi pirë kafe, ndërsa B..nuk ka qenë asnjëherë në banesë. Në atë kohë nuk kam qenë në punë por vëllezërit që janë jashtë vendit më kanë ndihmuar dhe nga shitja e narkotikëve kam pasur të ardhura për nevojat e mija personale. Më datën 07.10.2018 në Ferizaj rruga "...” kemi qenë duke luajtur Sony me Sh.., ndërsa F.. me P.. kanë qenë duke nderjtur, ndërsa rreth orës 21:00 në mbrëmje kanë ardhur policia, na kanë arrestuar dhe kanë gjetur 2 gram kokainë, 5 gram marihuanë, peshore etj.

3.4.2 I akuzuari SH.I., në mbrojtje të tij gjatë shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 08.10.2018 dhe në prokurori në Ferizaj me datën 30.11.2018, duke shtuar se punon si kamerier që së paku 8 vite, dhe se të akuzuarin SH.H e njeh që nga fëmijëria pasi që e ka pasur në klasë në shkollë fillore dhe janë të një katundi dhe me të njëjtin ka pasur raste që janë takuar çdo ditë por ndonjëherë edhe nuk ju ka ra me u pa, ndërsa të akuzuarit F.H e njeh si vëllai i Sh.., ndërsa të akuzuarin P.H e njeh vetëm si djali i axhës

së tyre, mirëpo më këta nuk ka pasur ndonjë raport sepse nuk i ka ra me ndejt. Ndërsa sa i përket ditës kritike, përkatësisht datës 07.10.2018, kur edhe policia ka bastisur banesën e të akuzuarit SH.Ht, i njëjti ka deklaruar se atë ditë ka qenë duke punuar më babanë e tij në ndërtimtari dhe pasi që e ka përfunduar punën në ora 2 pasdite, e ka thirr Sh.. me pi kafe tek kafiteria e një shokut të tyre që është quajtur “Empire”, mirëpo Sh... ka thënë se unë kafen e kam pi mirëpo kur e kryen ti hajde tek unë në banesë. Dhe më tutje ka deklaruar se ka shkuar në kafiterin Roso ku ka punuar dhe nuk i kujtohet se sa ka qëndruar dhe më vonë ka shkuar tek banesa e Sh....për të luajtur Sony, në të cilën banesë deklaroi se ka shkuar ndoshta 7-10 herë, mirëpo atë natë ka shkuar pasi që ka qenë edhe loja e futbollit Liverpool dhe Manchester City dhe kanë dashur që ta shikojnë bashkë, në banesë ka qenë vetëm Sh.i dhe Pajtimi ndërsa më vonë ka ardhur edhe Flamuri, dhe ka shtuar se pasi që është kryer loja kanë qenë në telefona të gjithë dhe pas 2-3 ore ka kërcit dera dhe kanë hyrë policia, duke shtuar se i njëjti nuk e ka ditur se pse kanë ardhur policia derisa i kanë shtrirë për tokë dhe i kanë lidhur dhe me pas e ka parë një polic i cili ka qenë kojshi i tij por prape nuk e ka ditur se çka është duke ndodhur derisa ka ardhur kryesori i njësisë dhe iu ka thënë që lironi le të ulen, dhe pastaj kanë filluar të bëjnë kontrollin e tyre fillimisht pastaj edhe të banesës dhe gjatë debatit e ka kuptuar se për çka bëhet fjalë. Më tutje ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni se Sh.. është marrë më ndonjë veprimtari ilegale, vetëm e di që një kohë ka punuar në pompë të benzinës dhe i ka pasur edhe vëllezërit në Zvicër, dhe atë ditë në banesë sa ka qëndruar por edhe herave të tjera ka deklaruar se ka parë shuma të parave 20-50 euro dhe ka parë disa qese të vogla me madhësi dikund 10 cm, por për të cilat nuk ka qenë kureshtar se çka janë sepse Sh.. është marrë edhe me fitnes dhe ka menduar që janë proteina, dhe se nuk e ka ditur se Sh..është duke u marrë me narkotik se po ta kishte ditur ndoshta do të ishte larguar nga ai, ngase nuk ka pasur asnjëherë biseda të tilla me të, dhe atë ditë gjatë bastisjes ka deklaruar se ka pasur zhurma dhe lëvizje të mëdha nga ta akuzuarit por nuk i kujtohet se çka kanë bërë pasi që ka pasur panikë për vete. I kujtohet se duke hyrë policia ka dëgjuar zhurmën e ujit në banjo- në llavabo por nuk i kujtohet se kush e ka lëshuar ujin, dhe ka shtuar se nuk ka qenë e as nuk është përdorues i substancave narkotike.

3.4.3 I akuzuari SH.B, në mbrojtje të tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në prokurori më datë 24.01.2019, duke shtuar se gjatë vitit 2018 ka punuar si kamarier në kafiterin “Empire” në Ferizaj, me tutje ka shtuar se të akuzuarin SH.H e ka njohur si myshteri i cili ka frekuentuar lokalitë në të cilin ka punuar ai dhe se me të nuk ka pasur raporte shoqërore por thjesht e ka njohur si myshteri dhe nuk ka qëndruar në shoqëri vetëm me të por edhe me shokë të tjerë kur kanë ndejt bashkë në një tavolinë. Më tutje ka shtuar se nga i akuzuari SH.H ka marrë borxh shumë e parave në vlerë prej 7000 euro, pasi që iu kanë dashtë për një vizë pune dhe është dashur që të ketë një pasqyrë të mirë bankare, dhe gjatë një muhabeti që ka pasur me shokët e tij në tavolinë ku ka qenë i pranishëm edhe i akuzuari Sh., ky i fundit i ka thënë se unë mund të ndihmojë në këtë drejtim dhe sipas tij ai ia ka dhënë këto para kesh, dhe pastaj Sh.i ka deponuar në llogarinë e tij bankare. Ndërsa ka deklaruar se kartelën e ka mbajtur Sh... sepse paratë kanë qenë të tij dhe për me i tërheq kurdo që i duhen. Më tutje ka shtuar se para arrestimit e ka bërë tërheqjen e të hollave në shumë prej 2000 euro të cilat ia ka tërhequr për Sh.in se atij ju kanë dashur, ndërsa shumë tjetër prej 4.998 euro i ka tërhequr pas arrestimit të Sh.. për arsyeja se i akuzuari A.M e ka telefonuar dhe i ka thënë që me ia kthye paratë e Sh.. familjarëve të tij se ju duhen, po ashtu ka deklaruar se vetura e Sh... ka qenë e regjistruar në emër të tij sepse Sh.. nuk ka pasur mundësi me regjistru në emër të vet sepse ka pasur shumë dënime

të kerreve e derisa ti kryen obligimet e tij ndaj shtetit nuk ka mundur me regjistru në emër të vet, dhe e ka ndier si obligim pasi që Sh.i i ka ndihmu me deponimin e të hollave, Sh..ia ka kthyer me regjistrimin e veturës në emrin e tij. Më tutje ka shtuar se me Sh.. nuk është se ka pasur raporte të mira shoqërore, mirëpo banesën e Sh.. e ka ditur se ku gjendet dhe i ka ra një herë më flejt tek banesa e tij së bashku me shefin e tij A.H dhe po ashtu ka deklaruar se pasi që është arrestuar Sh.., shefi i tij A. H.ka biseduar me të në telefon dhe pastaj ka biseduar edhe ky, dhe Sh..i ka kërkuar falje duke i thënë se të bëra problem edhe ty, dhe se nuk e ka ditur që i akuzuari SH.Ht merret me shitblerjen e substancave narkotike, ndërsa ka shtuar se ky nuk është marrë asnjëherë me këtë veprimtari.

3.4.4 Të akuzuarit F.H, B.B, A.H dhe A.M, gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fazën e mbrojtjes kanë deklaruar se i kanë kuptuar të drejtat e tyre dhe në konsultë me mbrojtësit e tyre kanë deklaruar se e shfrytëzojnë të drejtën që të mbrohem në heshtje në këtë fazë të procedurës.

4. Gjetjet e gjykatës (Vlerësimi dhe analizimi i provave lidhur me Pjesën Gjykuese A.)

4.1 Lidhur me pikën I të aktgjykimit.

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën konform nenit 362 par.2 të KPP-së, gjeti se ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë se të akuzuarit SH.H, F.H dhe B.B, kanë kryer veprën penale si në pikën I të aktgjykimit.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se SH.H, F.H dhe B.B, së bashku edhe me të akuzuarit/tani të dënuarit B.J dhe P.H, në vazhdimësi për periudhat kohore të cekura si në dispozitivin I të aktgjykimit, kanë marrë veprime në grup me qëllim që pa autorizim të shpërndajnë, shesin, transportojnë, ndërmjetësojnë në shitje, substanca narkotike të shpallura me ligj si substanca të ndaluara, respektivisht substancë narkotike të llojit “Kokainë” dhe Kanabis (Marihuanë). Të akuzuarit fillimisht sasinë e narkotikut e kanë sjellë nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, ashtu që të akuzuarit B.B dhe F. H., fillimisht e kishin siguruar narkotikun përkatësisht substancën narkotike “Kokainë” në Republikën e Shqipërisë, ndërsa i akuzuari tani i dënuari B.J, e kishte marrë atje dhe me pas e kishte transportuar – sjellë nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, ashtu që sasinë e narkotikut të cilën e kishte transportuar ia kishte dozuar të akuzuarit B.B në Ferizaj, i cili me pas së bashku me të akuzuarit tjerë SH.H, F.H dhe P.H-tani i dënuar, e kanë sistemuar në banesën të akuzuarve SH.H dhe P.H në Ferizaj, në rrugën “..” të cilën banesë e kishte marrë me qira i akuzuari Sh.., me qëllim që e njëjta të shfrytëzohet edhe nga të akuzuarit tjerë për të ushtruar këtë veprimtari kriminale përkatësisht shitjen e narkotikut. Të akuzuarit SH.H, P.H dhe F.H, nga kjo banesë kishin bërë edhe shitjen e substancave narkotikë të lartpërmendura duke iu shitur narkotik personave të ndryshim sipas kërkesës së tyre.

Faktin se të akuzuarit kishin vepruar në grup me qëllim që pa autorizim të shpërndajnë, shesin, transportojnë, ndërmjetësojnë në shitje, substanca narkotike të shpallura me ligj si substanca të ndaluara, respektivisht substancë narkotike të llojit “Kokainë” dhe Kanabis (Marihuanë) kjo vërtetohet përkatësisht nga veprimet e tyre të cilat janë vërtetuar nga provat të cilat gjykata i ka

administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht nga raportet e përgjimit i telekomunikimeve dhe raportet e vëzhgimit të cilat do të elaborohen në vijim.

Se të akuzuarit kishin vepruar në grup dhe kishin siguruar narkotikun përkatësisht substancën narkotike “Kokainë” në Republikën e Shqipërisë, vërtetohet nga raportet e përgjimit dhe vëzhgimit të datës 04.08.2018, ku vërtetohet se B.B dhe F.H kishin udhëtuar drejtë Republikës së Shqipërisë në datën e lartshënuar me veturën Audi A4, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit .., me qëllim të sigurimit të narkotikut dhe kjo vërtetohet përkatësisht nga komunikimet e të akuzuarve që kanë pasur atë ditë, përkatësisht të akuzuarit B.B, Flamur dhe SH.H dhe të akuzuarit tani të dënuarit B.J .

Nga raporti i vëzhgimit i datës së lartpërmendur vërtetohet se në të njëjtën ditë edhe akuzuari tani i dënuari B.J kishte shkuar në Republikën e Shqipërisë me qëllim që ta transportonte narkotikun për në Republikën e Kosovës ku konstatohet se i njëjti kishte kaluar pikën kufitare Vërmicë-Prizren në ora 07:45:02 min , ku i njëjti kishte udhëtuar me veturën Audi A4 , ngjyrë hiri me targa regjistrimi .. të cilën veturë e kishte marrë me renta dhe po ashtu ishte kthyer me të njëjtën ditë në ora 19:52:19 minuta.

Nga këto raporte të përgjimit të telekomunikimeve të datës 04.08.2018 vërtetohet se të njëjtit kishin pasur komunikim në mes vete përmes telefonave rreth organizimit përkatësisht sjellës së narkotikut nga Republika Shqipërisë në Republikën e Kosovës ku siç është theksuar dhe me lartë të akuzuarit B.B, F.H kishin shkuar së bashku ndërsa i akuzuari B.J i vetëm kishte shkuar në Republikën Shqipërisë. Nga të njëjtat raporte përkatësisht bisedave telefonike të cilat të akuzuarit i kanë bërë atë ditë mes vete vërtetohet se qëllimi i shkuarjes në Republikën e Shqipërisë ishte për sigurimin e narkotikut “Kokainës”. Nga bisedat telefonike vërtetohet se pas kthimit të akuzuarit B.B dhe F.H në Kosovë, ky i fundit përmes numrit të tij 044-995-400 tenton ta thirr të akuzuarin B.J në ora 16:17:28 minuta, në numrin e tij 049-400-884, ashtu që nuk mund të komunikojë ku shihet se nuk ia kishte hapur telefonin. Në ora 16:35:26 minuta, konstatohet se i akuzuari F.H e kishte thirr të akuzuarin SH.H dhe i kishte treguar se kishin hyrë në Republikën e Kosovës dhe e porositë të komunikojë me të akuzuarin B.J dhe të njëjtit i kishte treguar se kishte tentuar ta thirr edhe i akuzuari B.B por i akuzuari B.J nuk ishte lajmëruar. Pastaj, nga bisedat telefonike të SH.Ht shihet se ishte bërë komunikimi në datën e lartpërmendur në mes të Sh. H. dhe B.J, në orën 16:39:43 min, në të cilën bisedë kuptohet se i akuzuari B.J ishte ende në Republikën e Shqipërisë.

Nga raporti i vëzhgimit siç është theksuar me lartë është vërtetuar se atë ditë edhe i akuzuari B.J, kishte kaluar pikën kufitare në ora 19:52:19 minuta. Ashtu që nga raportet e përgjimeve të telekomunikimeve të datës 04.08.2018 vërtetohet se menjëherë i akuzuari B.J, pas kalimit të pikës kufitare e kishte thirr B. B.. Po ashtu në ora 20:43 minuta vërtetohet se përsëri B.. e kishte thirr B.B. dhe nga biseda kuptohet se kishin lënë të takohen në Ferizaj.

Nga raportet e vëzhgimit në të njëjtën ditë është vërtetuar se pasi që i akuzuari B.J kishte arritur në Ferizaj, i njëjti ishte takuar me të akuzuarin B.B në rrugën “ ..”, ku i njëjti shihet në ora 20:43:44 minuta, duke e pritur të akuzuarin B.J i cili vjen me veturën e llojit “Audi A4”, me targa të regjistrimit .. ku ndalet para të akuzuarit B.B, i cili futet në veturë dhe ndalen tek hyrja e rrugës “..”. Aty qëndrojnë brenda në veturë për disa minuta dhe në ora 20:50:14, i akuzuari B.B zbrit nga vetura më një çantë krahu dhe vazhdon ne rrugën “..” ku ka qenë edhe banesa të

cilën SH.H e kishte marrë me qira, ndërsa nga ky raport vërtetohet se B.J kishte vazhduar në drejtim të semaforëve nga kjo pjesë e qytetit të Ferizajit.

Nga bisedat e përgjimeve të telekomunikimeve të zhvilluara në mes të pandehurve F., Sh. dhe P.H, vërtetohet se të njëjtit në atë periudhë kishin biseduar me blerës përkatësisht konsumues të narkotikëve, të cilëve ju thonë se nuk kanë droge kokainë, mirëpo kërkojnë njëkohësisht që të presin deri në ora 20:30 minuta dhe pasi që B.B pranon drogën kokainë nga B.J, të njëjtit fillojnë tua shesin konsumuesve të ndryshëm, prandaj për këtë periudhë vërtetohet se shkuarja e të akuzuarve F. dhe B.B dhe B.J në Republikën e Shqipërisë ishte me qëllim që të sigurohej narkotiku “drogë Kokainë”.

Gjithashtu me të njëjtën metodë të akuzuarit B.B dhe F.H së bashku edhe me të akuzuarin Sh., P.H dhe B.J, kishin vepruar edhe me datën 06.10.2018, përkatësisht me datën 07.10.2018, kur edhe ishte zënë në flagrancë i akuzuari B.J duke transportuar narkotikun nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës, për grupin ku të njëjtit në pikën e kalimit kufitarë Vermicë - Prizren, i është gjetur sasia e substancës narkotike e llojit kokainë në shumë prej 549.44 ±0.0001 gram narkotikë të llojit kokainë, të cilën e kishte fshehur nënë rrobat të mbështjella për trupi.

Nga raportet e vëzhgimit vërtetohet se të akuzuarit B.B dhe F.H kishin udhëtuar për në Republikën e Shqipërisë me qëllim të sigurimit të narkotikut, dhe atë me datën 06.10.2018, ku konstatohet se të njëjtit kanë kaluar pikën kufitare në Vermicë, në ora 19:06 minuta, me veturën “Audi A4”, me targa të regjistrimit 05 449 DP, ngjyrë e zezë, kanë kaluar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Po ashtu, nga raporti i vëzhgimit i datës 07.10.2018, vërtetohet se i akuzuari tani i dënuari B.J kishte lëshuar Republikën e Kosovës përmes pikës kufitare në Vermicë, i cili në këtë pikë kishte kaluar në ora 12:00/h, me veturën “Audi A4”, me targa të regjistrimit ..., dhe i njëjti kishte shkuar me qëllim që ta transportonte substancën narkotike të llojit “Kokainë” për grupin, e të cilën narkotik paraprakisht kishin siguruar nga të akuzuarit B.B dhe F.Ht, të cilët kishin udhëtuar një ditë më parë për në Republikën e Shqipërisë, ashtu që i akuzuari B.J pasi që ishte kthyer atë ditë me datën 07.10.2018, nga e njëjta pikë kufitare kishte ardhur nga territori i Republikës së Shqipërisë me veturën e lartpërmendur në ora 20:15 minuta, ku edhe është ndalur në pikën kufitare të kontrollit të dokumentacionit në Vermicë, ku gjatë kontrollit i është gjetur sasia e narkotikut të lartpërmendur.

Siç është theksuar edhe më herët, nuk ka qenë kontestuese fare fakti se i akuzuari tani i dënuari B.J, transportimin e narkotikut nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës e kishte bërë për qëllime të grupit, përkatësisht grupit ku janë edhe të akuzuarit e tjerë, përkatësisht B.B, Sh. dhe F.H. Të akuzuarit/të dënuarit B.J dhe P.H, e kishin pranuar fajësinë qysh në shqyrtimin fillestar të cilët edhe janë shpallur fajtorë me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykatë me numër PS.nr.43/19 të datës 11.11.2019, se të njëjtit kanë vepruar në grup.

Faktin se i akuzuari SH.H, e kishte marrë me qira banesën në rrugën “..” në Ferizaj, ku në këtë banesë në ditën kritike janë arrestuar të akuzuarit; SH.H, P.H, F.H, dhe se qëllimi i mbajtjes së banesës ishte për të ushtruar veprimtari kriminale të grupit, vërtetohet nga vërtetimi mbi sekuestrimin e gjësendeve të datës 07.10.2018, e në të cilën banesë po ashtu janë gjetur sasi e narkotikut, qese të najlonit me substanca narkotike të llojit kokainë, po ashtu është gjetur një shah me figura të mbushura me substancë narkotike të llojit “marihuanë” dhe po ashtu është

gjetur edhe një peshore digjitale për matjen e narkotikut dhe shume të parave dhe gjësende tjera. Edhe nga dëgjimi i dëshmitares I. H., e cila ka qenë nëna e të akuzuarve Sh..dhe F.H, vërtetohet se të akuzuarit banesën e marr me qira e kishim mbajtur e fshehur edhe për familjarët e tyre, e cila kishte shërbyer për të ushtruar veprimtari kriminale të grupit shitjen e narkotikut, ku dëshmitarja gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: “*Sh.i ka pasur raste që nuk ka ardhur në shtëpi edhe kur ka munguar nuk është që na ka treguar se ku është mirëpo më vonë nga policia e kemi kuptuar që ai e kishte marrë një banesë me qira*”, pra nga deklarimi i saj del se e njëjta vetëm pas arrestimit të tyre nga policia e kishte kuptuar se kishin banesë me qira. nga djali i saj Sh. H..banesa ishte Po ashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitareve gjykata ka vërtetuar se të gjitha blerjet e narkotikeve të cilat kishin bërë dëshmitarët nga të akuzuarit ishin bërë për rreth lokacionit ku gjindet banesa e të akuzuarve.

Faktin se në banesën në rrugën ..”, janë gjetur se qeset e mbushura me narkotike nga të cilat vërtetohet se të akuzuarit e kanë ushtruar veprimtarinë për shitjen e narkotikut të llojit “kokainë”, vërtetohet edhe nga raporti i ekzaminimit të AKF-sëm me numër AKF/2018-3053/2018-3011 të datës 20.01.2019, ku është vërtetuar fakti se nga dëshmitë D#1.1, D#2, D#3, D#7.1, D#7.2, dhe D#10, të cilat janë marrë si dëshmi në vendin e ngjarjes të njëjtat kanë rezultuar se përmbajnë substanca narkotike e llojit “Kokainë” në peshë neto të përgjithshme prej 2 ± 0.0001 gram .

Po ashtu, nga i njëjti raport është vërtetuar se në figurat e shahut të cilat janë gjetur në këtë banesë e cila është evidentuar si dëshmia D#9, ka rezultuar se sasia e narkotikut e gjetur në këto figura përmban substanca narkotike e llojit “Kanabis” (Marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (TCH) në peshë neto 5.54 ± 0.0001 gram.

Nga raporti i ekzaminimit të AKF-së, me numër AKF/2018-3053/2018-3011, të datës 20.01.2019, gjithashtu është vërtetuar se sasia e narkotikut është gjetur në veturën e të akuzuarit/të dënuarit B.J, e cila është evidentuar si dëshmia D#1, e cila ka qenë e destinuar për grupin është vërtetuar se kjo substancë përmbajnë substanca narkotike e llojit “Kokainë” në peshë neto të përgjithshme në sasi prej 549.44 ± 0.0001 gram, ashtu që sipas këtij raporti gjykata ka vërtetuar se tërësia e sasisë së përgjithshme e cila është gjetur në banesën e të akuzuarve gjatë bastisjes dhe në veturën e të akuzuarit B.J, sipas karakteristikave të morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmitë D# 1, 1.1, 2, 3, 7.1, 7.2, dhe 10, është vërtetuar se përmbajnë Kokainë, peshë neto të përgjithshme 551.44 ± 0.0001 gram.

Gjykata, faktin e gjetjes fajtor të të akuzuarit SH.H, e ka vërtetuar me administrimin e një sërë provash në këtë çështje penale dhe atë:

Është e pa kontestueshme që i akuzuari SH.H, kishte bërë shitjen e narkotikut respektivisht substancë narkotike të llojit “Kokainë” dhe Kanabis (Marihuanë), ngase këtë fakte e ka pohuar edhe vet i akuzuari gjatë mbrojtjes së tij i cili ka pranuar se kishte bashkëpunuar me të akuzuarin/tani të dënuarin P.H në shtijën e narkotikut të llojit kokainë në Ferizaj. Po ashtu i njëjti ka pranuar se narkotiku i gjetur në këto figura e shahut në banesën e të akuzuarit që përmbante substanca narkotike e llojit “Kanabis” (Marihuanë) në peshë neto 5.54 ± 0.0001 gram, ishte me qëllim të dërgimit të saj në Burgun e Dubravws, tek shoku i tij M.. A.. Edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve; E.H, E. S., L. K, dhënë në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohet se i akuzuari SH.H ishte marrë me shitjen e substancës narkotike përkatësisht “kokainës dhe marihuanes”. Pra siç është theksuar edhe me parë, i njëjti edhe gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit gjyqësor ka pranuar

fajësinë për veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi, për çka gjykata ka refuzuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e tij për shkaqet dhe rrethanat të cilat janë cekur si tek pjesa e ecurisë së procedurës në këtë aktgjykim. Prandaj pa mëdyshje gjykata konsideron se është vërtetuar se i akuzuari SH.H ka kryer veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi.

Gjykata, faktin e gjetjes fajtor të të akuzuarit F.H, e ka vërtetuar me administrimin e një sërë provash në këtë çështje penale dhe atë:

Është e pa kontestueshme fakti se i akuzuari F.H kishte bërë sigurimin e substancave narkotike të llojit kokainë në Republikën e Shqipërisë së bashku me të akuzuarin B.B, të cilat veprime kanë të bëjnë me sigurimin e substancës narkotike, gjykata i ka elaboruar në pjesën më lartë të këtij aktgjykimi, që kryesisht është vërtetuar me anë të bisedave të telekomunikimit dhe nga raportet e përgjimit dhe vëzhgimit. Se i akuzuari F. H. ishte marrë kryesisht me sigurimin e narkotikut dhe ishte pjesë e grupit, vërtetohet nga dëshmia e dëshmitares B. F e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *“për blerjen e marhuanes dhe kokainës zakonisht ka komunikuar me Flamurin, mirëpo ishte takuar pastaj ose me Sh.in ose me Pajtimin dhe e ka blerë prej tyre, ajo ka shtuar se më kujtohet një rast kur e kam thirr në telefon Flamurin dhe e kam lënë me u taku tek nënkalimi në Ferizaj dhe pastaj kishte ardhur P.. nga i cili kishte blerë 0.3 gram kokainë dhe ajo ja kishte bërë pagesën prej 30€”*. Deklarata e kësaj dëshmitare për gjykatën është e besueshme për shkak se e njëjta ka lidhëni me transkriptën e bisedave telefonike të datës 01.09.2018, të zhvilluar ndërmjet F.Ht me numër telefoni 044 995 400, dhe dëshmitares B. F.me numrin e saj të telefonit, si dhe të akuzuarit P.H ku sipas bisedës B..fillimisht kontakton me F..i cili i thotë që të shkojë tek nënkalimi se do ta dërgojë një djalë, pastaj F.. kontakton me P.. dhe i thotë se po vjen B..tek nënkalimi dhe i tregon lidhur me sasinë e kërkuar nga ..B.. dhe nga komunikimi ndërmjet P.Ht dhe B. F. i të njëjtës datë, del se P..e kishte thirrur B.. dhe i thotë *“se Muli me tha me të thirr”*, ku pastaj të njëjtit takohen dhe ia shet narkotikun. Po ashtu, edhe nga komunikimi ndërmjet F.Ht dhe P.H në lidhje me dëshmitarin L. K që kishte bërë me datë 07.09.2018, vërtetohet se F.H ishte pjesë e këtij grupi.

Në raport me të akuzuarin F.Hn, për gjykatën kontestuese ka qenë fakti periudhës kohore, ku sipas aktakuzës i njëjti është akuzuari nga data 16.05.2018, e që në fakt nga shikimi i aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, të datave: 12.04.2018 dhe 08.06.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari F.H kishte qenë në paraburgim prej datës 12.04.2018 deri me datë 08.06.2018, prandaj gjykata konsideron se koha e përcaktuar në aktakuzë në raport me të akuzuarin F.H, nuk duhet të jetë nga data 16.05.2018, për shkak se i njëjti në këtë kohë ka qenë në paraburgim, por gjykata e ka vërtetuar se i njëjti ka vepruar për grupin pas daljes nga paraburgimi dhe atë pas datës 09.06.2018 deri me datë 07.10.2018, pra pas kohës kur i njëjti ishte liruar nga paraburgimi, ngase kjo kohë vërtetohet edhe nga aktvendimet e lartpërmendura të cilat mbrojtja i ka dorëzuar dhe propozuar si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj pa mëdyshje gjykata konsideron se është vërtetuar se i akuzuari F.H ka kryer veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi.

Gjykata, faktin e gjetjes fajtor të të akuzuarit B.B , e ka vërtetuar me administrimin e një sërë provash në këtë çështje penale dhe atë:

Është e pa kontestueshme fakti se i akuzuari B.B kishte bërë sigurimin e substancave narkotike të llojit kokainë në Republikën e Shqipërisë së bashku me të akuzuarin B.B, të cilat veprime kanë të bëjnë me sigurimin e substancës narkotike, gjykata i ka elaboruar në pjesën më lartë të këtij aktgjykimi, që kryesisht është vërtetuar me anë të bisedave të telekomunikimit dhe nga raportet e përgjimit dhe vëzhgimit. Sa i përket përgjegjësisë dhe fajësisë së të akuzuarit, gjykata konstaton se siç është theksuar edhe me parë, i njëjti edhe gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi, për çka gjykata ka refuzuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e tij për shkaqet dhe rrethanat të cilat janë cekur si tek pjesa e ecurisë së procedurës në këtë aktgjykim. Prandaj pa mëdyshje gjykata konsideron se është vërtetuar se i akuzuari SH.H ka kryer veprën penale nga pika I e këtij aktgjykimi.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së.

4.2 Lidhur me pikën II të aktgjykimit.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, i akuzuari B.B, e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së të përcaktuar si në pikën II të aktakuzës, andaj trupit gjykues pas marrjes së mendimit nga mbrojtësi dhe Prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit, ka marr aktvendimin me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B.B, për veprën penale për veprën penale të lartpërmendur për të cilën është ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tij avokatit Rafiz Shehu nga Ferizaj, dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit B.B ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

4.3 Lidhur me pikën III të aktgjykimit.

Lidhur me pretendimet e prokurorisë të parashtuara në pikën III të aktakuzës, se i akuzuari A.H, me qëllim të shpërndarjes së substancës narkotike të llojit “Marihuanë”, ka pranuar nga i akuzuari Sh..substancë narkotike në peshë prej 5.54 gram, të cilën substancë pastaj i akuzuari A..e ka vendosur dhe sistemuar në figurat e shahut, me qëllim që i akuzuari Sh. tabelën e shahut

ta dërgoj në qendrën korrektuese në Dubravë tek A.M.... me çka sipas akuzës kishte kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, e në veçanti duke analizuar transkriptin e përgjimeve të telekomunikimeve, përkatësisht bisedës të zhvilluara në mes të akuzuarit SH.H dhe M. A. të datës 29.09.2018, ora: 16:30:54 minuta, vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, me numër 2017 – DHTN – 896, të datës 07.10.2018 tek i akuzuari SH.H, raportin e ekzaminimit të AKF-së me numër AKF/2018-3053/2018-3011 të datës 20.01.2019, lidhur me dëshminë D#9, si dhe deklaratën e të akuzuarit SH.H, ka ardhur në përfundim se pretendimet e prokurorisë se i akuzuari A. A., kishte për qëllim të shpërndarjen e substancës narkotike të llojit “Marihuanë”, nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, ngase Gjykata nga provat e administruara përkatësisht provave të lartpërmendura ka vërtetuar tjetër gjendje faktike se qëllimi i të akuzuarit A. nuk ishte që ai të shpërndante substancën narkotike të llojit “Marihuanë”, mirëpo qëllimi-dashja e tij ishte për ti ndihmuar të akuzuarit SH.H, me qëllim të shpërndarje narkotiku të llojit “Marihuanë”, duke i krijuar kushte për shpërndarje, ashtu që i njëjti ka pranuar nga i akuzuari Sh.. substancë narkotike në peshë prej 5.54 gram, të cilën substancë pastaj i akuzuari A.. e ka vendosur dhe sistemuar në figurat e shahut, me qëllim që i akuzuari Sh.. tabelën e shahut ta dërgoj në qendrën korrektuese në Dubravë, tek i dënuari M. A. i cili ishte në vuajtje të dënimit në këtë qendër.

Gjykata këtë gjendjen faktike e ka vërtetuar nga transkriptin e përgjimeve të telekomunikimeve, përkatësisht bisedës të zhvilluara në mes të akuzuarit SH.H dhe personit M. A. të datës 29.09.2018, ora: 16:30:54 minuta, në të cilën shihet biseda e zhvilluar në mes tyre lidhur me kërkesën e M. A. për SH.Hn që narkotiku të vendoset nga M.A.në figurat e shahut dhe pastaj të bëhet dërgimi i substancës narkotike të llojit “Marihuanë” në Qendrën e Paraburgimit në Dubrave, ku ishte në vuajtje të dënimit personi M.A..

Gjatë bisedës vërtetohet se M..i drejtohet me fjalët: *“folja me atë të .., um tha a e din se kam mëndu që se e kom thirr ma prej asaj dite, tha sum ka thirr kerkush... oo i thash sun e kam gjet shahun, sot e ka gjete, i thash a me ta pru, tha po bjerma, tha veç kallxoj atij shokit tanë le të me kallxon pak afërsisht çka me ba , o Sh.. ti pe kupton qysh duhet..., a pe kupton qysh duhet me mbush qato, a mundesh ti veç me ja spjegu pak, i thu e merr barin ja hek ata drunat a pe din e grimcon kapak edhe e din e banë copa të vogla dhe e shtin i prezivat (preson) mirë i shtyp shumë a pe din”* i akuzuari Sh..ia kthen përgjigjej: *“a mi pështjell me najsen ato apo”*

Në këtë bisedë në mënyrë të detajuar personi M.. ia shpjegon të akuzuarit SH.H vendosjen se si duhet të veproje M.. për vendosjen e narkotikut ne figurat e shahut dhe se ishte fjalë për të akuzuarin A.H gjykata e ka vërtetuar nga sms i po kësaj date ku M. A ia dërgon mesazh SH.Ht emrin e të akuzuarit A.H me tekstin “Arburimi Gremë- 045 515 526”. Po ashtu edhe nga vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të gjësendeve, me numër 2017 – DHTN – 896, të datës 07.10.2018 tek i akuzuari SH.H, vërtetohet se shahu së bashku me figurat e mbushura me narkotik është gjetur në banesën e të akuzuarit SH.H të cilën e kishte marrë me qira e në të cilën e zhvillonte aktivitetin e tij për shpërndarjen dhe shitjen e narkotikeve, përkatësisht kokainës dhe marihuanes.

Nga raporti i ekzaminimit të AKF-së me numër AKF/2018-3053/2018-3011 të datës 20.01.2019, lidhur me dëshminë D#9, ku si dëshmi kanë qene edhe figurat e shahut, gjykata ka vërtetuar faktin se dëshmitë D#9, përmban kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (TCH) pesha neto: 5.54 ± 0.0001 gram.

Edhe i akuzuari SH.H gjatë mbrojtjes së tij e pranon faktin se i kishte dërguar shahun së bashku me figurat te i akuzuari A.H sipas porosis që kishte marrë nga personi M. A. mirëpo i njëjti mohon faktin se A.. i kishte vendosur narkotikun në figurat e shahut ku i njëjti thotë se A.. kishte bërë vetëm hapjen e figurave dhe se ky kishte bërë vendosjen dhe mbylljen figurave të shahut, mirëpo mbrojtja e të akuzuarit Sh.. lidhur me këtë fakt është tërësisht në kundërshtim me transkriptin e bisedës ku me personin M. A.. gjatë bisedës i thotë SH.Ht; “ *thuj mbushi veç figurat dhe kallxom sa të kanë mbet, veç kallxom saktë sa ke shti a e din*” ashtu që i akuzuari Sh. ja kthen bisedën “ *ani de*”, prandaj gjykata nga të lartpërmendurat ka ardhur në përfundim se i akuzuari A.H kishte pranuar shahun së bashku me figura dhe narkotikun nga i akuzuari SH.H, që të bënte shpimin e figurave të shahut me qëllim të vendosjes së narkotikut në to dhe pastaj ta bënte mbylljen e figurave me qëllim të krijimit të kushteve përkatësisht shpërndarjes - dërgimit të narkotikut tek personi M. A. i cili gjendej në Burgun e Dubraves në vuajtje të dënimit, dhe me këtë rast i njëjti i kishte ndihmuar të akuzuarit SH.H për qëllim të shpërndarjes së narkotikut të cilin e kishte në posedim.

Meqenëse nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se nuk ishte qëllimi i të akuzuarit A.H ai të bënte shpërndarjen e narkotikut, mirëpo që qëllimi i tij ishte për të ndihmuar përkatësisht për të krijuar kushte për shpërndarjen e narkotikut për të akuzuarin SH.H, trupi gjykues në rastin konkret ka bërë ri cilësimin e veprës penale nga blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së (siç ishte akuzuar nga ana e prokurorisë) në veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së⁶.

Gjatë ri – cilësimit të veprës penale për të akuzuarin A.H nga vepra penale blerja posedimi, shpërndarja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, në veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale blerja posedimi, shpërndarja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, gjykata mori parasysh faktin se i akuzuari SH.H është shpallur fajtor për veprën penale nga neni 273 par.2 të KPRK-së, andaj meqenëse vepra penale nga neni 273 i KPRK - së, në paragrafin 1 ka si element inkriminuas shpërndarjen ku përcaktohet se: “*kushdo që paautorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes...*”, dhe gjithashtu edhe në paragrafin 2 ka si element inkriminuas ky paragraf ka shpërndarjen ku përcaktohet se “*kushdo*

⁶ Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 360 par.2 të KPP-së në të cilën është parashikuar se “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, ka vendosur që bëjë ricilësimin e veprës penale nga blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së (siç ishte akuzuar nga ana e prokurorisë) në veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

që pa autorizim shpërndan....”, gjykata duke u bazuar edhe në nenin 360 par.2 të KPP-së për të akuzuarin A.H ka bërë ri-cilësimin veprën penale nga aktakuza dhe e ka shpallur fajtor për veprën penale sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se është vërtetuar se dashja-qëllimi i të akuzuarit A.H ishte për ti ndihmuar të akuzuarin SH.H, përkatësisht i njëjti ishte në dijeni se me vendosjen dhe sistemimin e substancës narkotike në peshë prej 5.54 gram në figurat e shahut ishte duke i krijuar kushte për të akuzuarin Sh.. me qëllim që ky fundit ta shpërndante, përkatësisht ta dërgonte tek personi M. A. i cili ishte në vuajtje të dënimit në Burgun e Durbravës, prandaj duke marr për bazë sasinë e narkotikut e cila është gjetur në figurat e shahut, faktin se sipas aktakuzës i akuzuari A. A. ishte akuzuar për veprën penale nga neni 273 par.1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari SH.H është shpallur fajtor për veprën penale nga neni 273 par.2 të KPRK-së dhe meqenëse paragrafi 1 dhe 2 i nenit 273 të KPRK- së siç është theksuar edhe më latë kanë si element të përbashkët shpërndarjen,

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit A.H ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale blerja posedimi, shpërndarja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, për shkak se i njëjti me dashje i kishte ndihmuar të akuzuarit SH.H në shpërndarjen e narkotikut.

4.4 Lidhur me pikën IV të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një në lidhmëri me njëra tjetrën, nga të cilat gjeti se ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë dhe vërtetojnë se i akuzuari SH.H ka kryer veprën penale si në pikën IV të aktgjykimit.

Sipas nenit 56 par.1 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit përcaktohet se: *“Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon: nënparagrafi 1.1. përcakton se: “konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë”*; ndërsa nën paragrafi 1.5 përcakton se: *“fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla”*

Nga provat e administruara nuk ka qenë kontestuese fakti se i akuzuari SH.H ishte marrë me shitjen e narkotikut dhe se pasuritë e përshkruara si në dispozitivin IV të aktgjykimit kanë qenë pasuri të cilat janë fituar nga kryerja e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 , nën par.1.1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si në dispozitivin I të aktgjykimit.

Se i akuzuari SH.H duke e ditur se pasuria e përshkruara si në dispozitivin IV të aktgjykimit ishte fituar me vepër penale dhe i njëjti me qëllim fshehjes dhe maskimin e natyrës së burimit të pasurisë i kishte transferuar tek të akuzuarit tjerë, kjo vërtetohet fillimisht nga veprimet e të akuzuarit Sh..., i cili me qëllim që ta fsheh-maskojë pasurinë e fituar me kryerjen veprës penale përkatësisht paratë që i kishte fituar me anë të shitjes së narkotikut, i kishte bartur-transferuar tek të akuzuarit tjerë A.M dhe SH.B, ku në xhirollogaritë e tyre bankare kishte deponuar shuma të parave dhe atë: tek i akuzuari A.M kishte deponuar shumën prej 36,875.00 Euro, ndërsa tek i akuzuari SH.B kishte deponuar shumën prej 7,000.00 Euro. Gjithashtu i akuzuari Sh..., tek i akuzuari SH.B kishte bartur në emrin e tij edhe veturën e tij BMW me targa të regjistrimit 05-677-EC, me qëllim që ta maskojë këtë pasuri, po ashtu nga parat që i njëjti kishte fituar nga narkotiku kishte blerë edhe sende të tjera të luajtshme përkatësisht automjetet tjera të cilat janë përshkruar si në pikën IV të aktgjykimit. Se pasuria-paratë, ishin fshehur, maskuar nga i akuzuari Sh., vërtetohet edhe nga vet deklaratat e dëshmitares I.H. (nëna e të akuzuarit SH.H), e cila gjatë dëshmisë së saj në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: *“nuk ka qenë në dijeni se Sh... këto të holla i ka pasur në xhirollogari të akuzuarit A. M..dhe Sh. B.. Të akuzuarin A. nuk e kishte njohur më parë dhe se ishte hera e parë kur e kishte takuar, i njëjti e kishte thirr në telefon dhe ishin takuar 30 m larg shtëpisë dhe ia kishte dhënë shumën e parave në vlerë prej 5,000 Euro ku Ardoniti i kishte thënë se merri këto para se të Sh.. janë se të vyn”*. Deklarata e dëshmitares I.H. është në harmoni edhe me mbrojtjen e të akuzuarin SH.B i cili po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“para arrestimit e ka bërë tërheqjen e të hollave në shumë prej 2000 Euro të cilat ia ka tërhequr për Sh.. se atij ju kanë dashur, ndërsa shumën tjetër prej 4.998 Euro i ka tërhequr pas arrestimit të Sh.. për arsyeja se i akuzuari A.M e ka telefonuar dhe i ka thënë që me ia kthye paratë e Sh.. familjarëve të tij se ju duhen..”*. Deklarimi i të akuzuarit është në harmoni edhe me pasqyrën e llogarisë bankare në Bankën Ekonomike të vet të akuzuarit SH.B, nga e cila vërtetohet se me datën 09.10.2018 ishte bërë tërheqje e parave në vlerë prej 4.998 Euro, po ashtu edhe nga pasqyra e llogarisë bankare në NLB Bankë e të akuzuarit A.M vërtetohet se me datën 09.10.2018 ishte bërë tërheqje e parave në vlerë prej 18.000 Euro, pra këto dy tërheqja nga ana e të akuzuarve Sh.. dhe A.. ishin bërë dy ditë pas arrestimit të akuzuarit Sh.. i cili ishte arrestuar me datën 07.10.2018. Në këtë drejtim edhe i akuzuari A.M edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësorë ishte mbrojtur në heshtje i njëjti gjatë marrjes në pyetje në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, në prezencën e mbrojtësit të tij e kishte pranuar faktin se paratë që i kishte deponuar në llogarinë bankare të tij kanë qenë të akuzuarit SH.H dhe se shumën prej 18.000 Euro që e kishte tërhequr me datën 09.10.2018 ia kishte dorëzuar nënës së Sh.. pas arrestimit të Sh.. dhe kartelën bankare të tij të NLB Bank e kishte mbajtur i akuzuari SH.H.

Prandaj, nga të lartpërmendurat vërtetohet se për paratë të cilat i akuzuari Sh..i kishte në xhirollogaritë e të akuzuarve A.M dhe SH.B, nuk kishte dijeni as nëna e tij, pra dëshmitarja e lartpërmendur ka theksuar se për këto para kishte kuptuar vetëm pas arrestimit të të akuzuarit Sh..., pra i akuzuari Sh.. këto para i kishte mbajtur të fshehur edhe nga prindërit e tij dhe i kishte bartur - transferuar tek të akuzuarit tjerë, me qëllim që të maskohej pasuria.

Se i akuzuari SH.H paratë e deponuara në llogaritë e akuzuarve A.M dhe SH.B si dhe pasuritë e luajtshme përkatësisht automjete e përshkruara si në pikën IV të aktgjykimit i kishte fituar me kryerjen e veprës penale, kjo vërtetohet me vet faktin se i akuzuari në periudhën kohore për të cilën akuzohet ishte i papunë dhe nuk kishte të ardhura nga ndonjë aktivitet i ligjshëm, i njëjti e pranon se para kësaj periudhe kishte punuar në kompaninë “Al Petrol” si shitës në market ku

kishte një pagë prej 275 euro, mirëpo kontrata e tij kishte përfunduar në vitin 2016, e që kjo vërtetohet nga kontrata e punës e datës 26.11.2014 e lidhur në mes të Sh.p.k “Al Petrol” si punëdhënës dhe Sh. H., pra i njëjti pas përfundimit të kontratës me Sh.p.k “Al Petrol” ishte i pa punë dhe nuk ishte marrë me ndonjë aktivitet të ligjshëm ku edhe vet i njëjti gjatë mbrojtjes së tij e pranon se e vetmja punë që kishte bërë ishte ajo si shitës në market në Al Petrol për periudhën si në kontratë ashtu i njëjti e pranon faktin se ishte marrë me shitblerjen e narkotikut dhe të ardhurat nga shitja e narkotikëve i kish për nevoja të tij personale dhe me asnjë provë tjetër nuk është dëshmuar se këto para, përkatësisht këto pasuri i kishte fituar në mënyrë të ligjshme.

Se i akuzuari SH.H kishte marrëveshje paraprake për maskimin e pasurisë përkatësisht parave të deponuara në llogaritë e të akuzuarve A.M dhe SH.B, ky fakt vërtetohet edhe nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 07.08.2018 ku në banesën e të akuzuarit Sh.H. të cilën e shfrytëzonte për aktivitet kriminal përkatësisht për shpërndarjen dhe shitjen e narkotikut, janë gjetur debit kartela e Bankës Ekonomike në emër të akuzuarit SH.B dhe debit kartela e NLB bankës në emër të akuzuarit A.M e të cilat kartela bankare i akuzuari Sh.. i kishte marr nga të akuzuarit lartpërmendur dhe në këto llogari kishte qasje të drejtpërdrejtë, pasi nga të akuzuarit kishte marr dhe kodin e debit kartelave dhe ky fakt më së miri vërtetohet edhe nga mbrojtja e të akuzuarit SH.B i cili gjatë mbrojtjes së tij ka pranuar faktin “*se kartelën e ka mbajtur Sh...sepse paratë kanë qenë të tij për me i tërheq kurdo që i duhen*”. Pra nga të lartpërmendurat vërtetohet saktë se i akuzuar Sh. H. në llogaritë e të akuzuarve të lartpërmendur kishte qasje çdo herë kur ato para iu nevojiteshin për nevojat e tij personale.

Edhe vet i akuzuari SH.H, gjatë mbrojtjes së tij e pranon faktin se paratë të cilat ishin deponuar në llogari të akuzuarit SH.B dhe veturën BMW 120D me targa të regjistrimit ... kanë qenë pasuri e tij, mirëpo i njëjti arsyetohet se paratë i kishte deponuar në llogari të Sh... për qëllim të qarkullimit bankar për Sh., shkak se i njëjti kishte për të marrë vizën dhe këto para kanë qenë kursime që i kanë dërguar vëllezërit dhe që i kishte fituar nga shitblerja e veturave dhe nuk ishin fituar nga shitja e narkotikut. Gjykata konsideron se ky deklaram i tij është me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe në kundërshtim me provat të cilat gjykata i ka elaboruar më lartë dhe se deklarimi i të akuzuarit se paratë i kishte nga kursimet e parave që i kishin dërguar vëllezërit e tij dhe shitja e automjeteve është me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është tërësisht në kundërshtim me vet deklaratën e dëshmitares I. H. e cila gjatë dëshmisë së saj ka deklaruar se “*nuk ishte në dijeni për paratë që ishin deponuar në llogaritë e të akuzuarit Sh.. dhe po ashtu djemtë të cilët i kishte në Zvicër kur kanë ardhur paratë na kanë dhënë mua dhe burrit dhe ne kemi menaxhuar me to*” dhe po ashtu është në kundërshtim me provat të cilat do të elaborohen më poshtë në lidhje me analizën rreth pretendimeve të mbrojtësit.

Pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit SH.H, avokati Islam Musa se pasuria që është përshkruar në aktakuzë nuk është fituar me vepër penale por është pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme nga i akuzuari , ngase “*babai i të akuzuarit Sh., e ka shitur një paluajtshmëri në çmim prej 18,478.00 Euro si dhe fakti se i akuzuari gjatë vitit 2015 ka marrë kredi në shumën prej 4,000.00 Euro, ka punuar më se dy vite në SH.P.K “Al Petrol” në Ferizaj dhe ka realizuar pagë mujore prej 275.00 Euro, si dhe i mbrojturi i tij ka dy vëllezër në Zvicër të cilët me vite punojnë atje dhe gjithnjë i kanë sjellë para të mbrojturit të tij*”, këto pretendime janë të pabazuara për shkak se kjo është në kundërshtim edhe me raportin e hetimeve financiare për të akuzuarin SH.H, nga i cili konstatohet

se i njëjti gjatë vitit 2016 kishte deponuar shumën prej 31,700.00 euro, për të cilat i njëjti nuk kishte arsyetuar se të njëjtat rrjedhin nga ndonjë burim i ligjshëm, por është vërtetuar se të njëjtat rrjedhin nga aktiviteti kriminal përkatësisht trafikimi dhe shitja e narkotikut dhe këto mjete kanë qenë të fituara nga ky aktivitet. Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se shumatat që pretendohet se janë përfituar nuk ishte pasuri e përfituar me vepër penale por ishte pasuri e ligjshme dhe se paratë të akuzuarit ia kishin dërguar vëllezërit e tij, sipas vlerësimit të gjykatës këto pretendime janë të pabazuara për shkak se nga raporti i hetimit financiar të datës 28.01.2019 vërtetohet se shuma e përgjithshme që kishte pranuar i akuzuari Sh.. e të cilat ishin dërguar përmes Western Unionit nga viti 2015 deri në vitin 2018, ishin 7 dërgesa në shumë të përgjithshme prej 2.589,03 euro, ndërsa për pagat mujore të cilat i kishte marrë SH.P.K “Al Petrol” në Ferizaj ishin nga data 02.02.2015 deri më 08.04.2016 në shumë të përgjithshme 3.439,19 euro dhe po ashtu kredia ishte marrë me 23.12.2015, në shumë prej 3.900,12 Euro, prandaj të gjitha këto janë jashtë periudhës kohore të aktivitetit kriminal për të cilën është dyshuar i akuzuari, ashtu që këto shuma nuk janë përfshirë sipas të njëjtit raport që ishin fituar nga aktiviteti kriminal, mirëpo shuma e deponuar nga i akuzuari në llogarinë e tij në vlerë prej 31,700.00 euro dhe veturat të cilat janë përshkruar në dispozitiv të akuzës nga i akuzuari ishin blerë gjatë vitit 2017, janë pasuritë të cilat i akuzuari i kishte fituar nga aktiviteti kriminal përkatësisht shitja e narkotikëve, për shkak se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se të njëjtat rrjedhin nga ndonjë aktivitet i ligjshëm.

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarit SH.H në pikën IV të aktgjykimit ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale shpëlarje e parasë nga neni 308 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

4.5 Lidhur me pikën V dhe VI të aktgjykimit.

Gjykata ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtat i vlerësoi një nga një në lidhmëri me njëra tjetrën, nga të cilat gjeti se ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë dhe vërtetojnë se i akuzuari SH.B ka kryer veprën penale si në pikën V të aktgjykimit, ndërsa i akuzuari A.M ka kryer veprën penale si në pikën VI të aktgjykimit.

Sic është theksuar edhe më lartë elementet e veprës penale të Shpërlarjes së parasë, janë përcaktuar sipas nenit 56 par.1 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në të cilat përcaktohet se: *“Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale,.....”*.

Nga provat e administruara nuk ka qenë kontestuese fakti se të akuzuarit SH.B dhe A.M, i kanë ndihmuar të akuzuarit SH.H në fshehjen dhe maskimin e pasurisë e cila kishte buruar nga aktiviteti kriminal, përkatësisht nga vepra penale shitja e narkotikëve, ashtu që i kanë krijuar kushte duke ia dhënë kartelat bankare të akuzuarit SH.H, i cili për ta fshehur apo maskuar natyrën e burimit të parave të cilat i kishte fituar me kryerjen e veprës penale të narkotikut, i njëjti kishte deponuar paratë në llogaritë bankare të akuzuarve dhe atë: në llogarinë bankare të akuzuarit Sh. B në Bankën Ekonomike shumë prej 7000 Euro, ndërsa në llogarinë bankare të akuzuarit A. M. shumë e përgjithshme prej 36, 875.00 euro. Fakti se të akuzuarit SH.B dhe

A.M, ia kishin dhënë kartelat bankare të akuzuarit Sh., fillimisht vërtetohet nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 07.08.2018, në të cilin konstatohen se në banesën e të akuzuarit SH.H të cilën e shfrytëzonte për aktivitet kriminal janë gjetur edhe dy (2) kartelat bankare të lartpërmendura të akuzuarve SH.B dhe A.M, të cilat kartela i shfrytëzonte i akuzuari Sh., për të deponuar para që i fitonte nga shitja e narkotikeve. Edhe vet i akuzuari SH.B nuk e ka mohuar faktin se ia kishte dhënë kartelën bankare të Bankës Ekonomike të akuzuarit Sh.. i cili e dinte edhe pinin-kodin e kartelës dhe kishte qasje në llogarinë e tij bankare. Poashtu edhe i akuzuari A.M edhe pse gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje, në deklaratën e tij të dhënë Prokurorinë Themelore në Ferizaj, në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit E.Sh. nga Ferizaji, e ka pranuar faktin se kartelën ia kishte dhënë të akuzuarit Sh.. i cili e kishte mbajtur dhe se e dinte pinin e kartelës së tij dhe se i akuzuari Sh..kishte qasje në llogarinë e tij. Prandaj nga të lartpërmendurat nuk ka qenë fare kontestuese fakti se të akuzuarit me dhënien e kartelave bankare i kishin ndihmuar të akuzuarit Sh..në fshehjen – maskimin e cila ishte fituar me veprën penale, përkatësisht të shumës së parave të deponuara në llogaritë e lartpërmendura.

Se të akuzuarit SH.B dhe A.M kanë pasur arsye për të ditur se pasuria përkatësisht paratë të cilat i kishin deponuar në llogarite e tyre bankare kanë qenë pasuri e fituar në forme të aktivitetit kriminal, përkatësisht veprës penale shitjes së narkotikut, vërtetohet nga fakti se vet të akuzuarit Sh.. dhe A.. nuk e kanë mohuar faktin se kanë pasur raporte të afërta shoqërore me të akuzuarin SH.H. Vet i akuzuari SH.B gjatë mbrojtjes së tij kishte deklaruar se me të akuzuarin kishte raporte shoqërore dhe të njëjtin e kishte njohur në kafiterinë Empire në Ferizaj ku punonte, si myshteri dhe po ashtu i njëjti ka pranuar se kishte fjetur në banesën e të akuzuarit SH.H një herë. Po ashtu edhe i akuzuari A.M gjatë deklaratimit të tij në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit Ekrem Shabani nga Ferizaji kishte deklaruar se me të akuzuarin SH.H kishte raporte shoqërore dhe se në banesën e të akuzuarit Sh. kishte qenë përafërsisht dhjetë(10) herë. Prandaj gjykata vlerëson se në rastin konkret duke marrë për bazë se të akuzuarit Sh.. dhe A.M kanë pasur raporte shoqërore me të akuzuarin dhe po ashtu të njëjtit e kishin vizituar banesën e të akuzuarit Sh. e cila kryesisht ishte shfrytëzuar për zhvillimin e aktivitetit kriminal, përkatësisht shitjen e narkotikut nga ana e të akuzuarit SH.H dhe duke marrë për bazë që gjatë bastisjes nga ana e policisë është gjetur drogë tek kjo banesë, kjo tregon qartë se të akuzuarit Sh.. dhe A.. kanë mundur të dijnë për aktivitetin kriminal të tij, e në veçanti duke marrë për bazë faktin se i akuzuari A.M gjatë deklaratës në Prokurorinë Themelore në Ferizaj kishte deklaruar se: “ *në fillim nuk kam pasur njohuri për prejardhjen e këtyre parave kurse më vonë respektivisht 5-6 muaj, kam kuptuar se i njëjti është duke punuar me drogë dhe kam dyshuar se paratë janë të fituara me anë të shitjes së drogës* ”. Andaj kur merret parasysh fakti se të njëjtit ishin në raporte shoqërore dhe se i akuzuari SH.H në periudhën kur janë deponuar paratë kishte qenë i pa punë dhe nuk ishte marrë me ndonjë aktivitet tjetër të ligjshëm, kjo e vërteton faktin se të akuzuarit kanë pasur arsye për rrethanat e lartpërmendura për të ditur se paratë kanë rrjedhur nga aktiviteti kriminal.

Gjithashtu faktin se kanë mundur të dinë se pasuria buron nga një aktivitet kriminal vërtetohet nga veprimet e të akuzuarve SH.B dhe A.M, pas arrestimit të akuzuarit SH.H, të cilët menjëherë dy ditë pas arrestimit ia kthejnë shumën e parave të cilat i kishin të deponuara ende në llogaritë bankare të tyre duke ia dhënë nënës së të akuzuarit SH.H. Dhe kjo vërtetohet edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit SH.B, i cili po ashtu gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se “*ndërsa shumën tjetër prej 4.998 Euro i ka tërhequr pas arrestimit të Sh.it për arsyeje se i akuzuari A.M e ka*

telefonuar dhe i ka thënë që me ia kthye paratë e Sh.it - familjarëve të tij se ju duhen... ”. Po ashtu edhe A.M gjatë deklarimit në Prokurorinë Themelore në Ferizaj kishte deklaruar se: “po e kam bërë tërheqjen dy ditë pasi është arrestuar i akuzuari Sh., i kam tërhequr 18.000,00 euro.. dhe ia kam dorëzuar nënës së Sh.it të gjitha paratë”. Pra nga vet kjo deklaratë vërtetohet se të akuzuarit SH.B dhe A.M ishin në dijeni se pasuria përkatësisht paratë që kanë qenë të deponuara në llogaritë bankare kanë qenë burim nga aktiviteti kriminal, përkatësisht pasuri e cila ishte fituar me vepër penale, shitjen e narkotikut.

Pretendimet e mbrojtësit e të akuzuarit SH.B avokatit Fitim Shabani, se paratë të cilat i kishte deponuar i akuzuari Sh.. kanë qenë për rregullimin e pasqyrës së llogarisë bankare të akuzuarit me qëllim që pastaj të aplikojë për vizë dhe se veturën e kishte regjistruar për shkak se nuk kishte mundur Sh.i që ta regjistronte në emër të tij për shkak të gjobave që kishte e të cilat i kishin pa mundur regjistrimin, këto pretendime sipas vlerësimit të gjykatës janë të pa bazuara për shkak se vet i akuzuari SH.B, gjatë mbrojtjes së tij ka pranuar faktin se nuk kishte aplikuar asnjëherë për ndonjë vizë në ndonjë ambasadë, prandaj deklarimi i tij se paratë i kishte deponuar me qëllim që ta rregullonte pasqyrën e tij bankare për aplikim për vizë, gjykata vlerëson se është në kundërshtim me vet mbrojtjen e tij dhe se është thjesht me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, ndërsa sa i përket regjistrimit të automjetit po ashtu gjykata vlerëson se edhe ky deklarim është me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, për shkak se edhe për këtë rrethanë gjykata vlerëson se i akuzuari ka pasur arsye për të ditur se kjo pasuri buron nga aktiviteti kriminal përkatësisht nga shitja e narkotikut që kishte bërë i akuzuari SH.H.

Gjithashtu pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit A.M, avokatit Kushtrim Obrazhda se i akuzuari A..nuk kishte për qëllim që të fshehë apo maskojë pasurinë për ndonjë aktivitet kriminal por këto e kishte bërë vetëm si shërbime për të akuzuarin Sh., i cili kishte kredi në llogarinë e tij bankare dhe banka do të ja merrte paratë nga llogaria, këto pretendime janë të pa bazuara për faktin se fillimisht ky pretendim është në kundërshtim me vet deklaratën e të akuzuarit A..të dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i cili kishte deklaruar se: “ në fillim nuk kam pasur njohuri për prejardhjen e këtyre parave kurse më vonë respektivisht 5-6 muaj, kam kuptuar se i njëjti është duke punuar me drogë dhe kam dyshuar se paratë janë të fituara me anë të shitjes së drogës”, pra kjo vërteton faktin se ai ishte në dijeni për aktivitetin e tij kriminal dhe aq më tepër dijeninë e tij për këtë aktivitet e forcon edhe veprimet e tij i cili po ashtu gjatë deklaratës në Prokurorinë Themelore në Ferizaj e pranon se dy ditë pas arrestimit paratë i kishte tërhequr nga llogaria e tij dhe ia kishte dorëzuar nënës së SH.H. Gjithashtu gjykata ka vërtetuar se nga raporti përmbledhës i hetimeve financiare i datës 28.01.2019, për periudhën kohore për të cilën ngarkohet i akuzuari SH.H nuk del se i njëjti kishte ndonjë detyrim – borxh në ndonjë prej bankave që vepron në Republikën e Kosovës.

Meqenëse nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se qëllimi i të akuzuarve SH.B dhe A.M ishte për ti ndihmuar të akuzuarit SH.B në fshehjen dhe maskimin e natyrës dhe burimit të pasurisë së tij, trupi gjykues në rastin konkret ka bërë ri cilësimin e kualifikimit të veprave penale në pikën V dhe VI të aktakuzës që ka të bëjë me të akuzuarit SH.B dhe A.M nga vepra penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (siç ishte akuzuar nga ana e prokurorisë), në veprën penale shpëlarje e parasë nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56

par.1 nënpar.1.6 lidhur me 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.⁷

Andaj, mbi këto baza dhe konstatime gjykata ka vërtetuar faktin se në veprimet e të akuzuarve SH.B dhe A.M në pikën V dhe VI të aktgjykimit, ekzistojnë dhe formohen të gjitha elementet e veprës penale shpëlarje e parasë nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.6 lidhur me 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, për shkak se të njëjtit me dashje i kishin ndihmuar të akuzuarit SH.H për të kryer veprimet të cilat janë përcaktuar dhe përmendur në nën paragrafin 1.1 dhe 1.5 të nenit 56 par.1 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

5. Gjetjet e gjykatës (Vlerësimi dhe analizimi i provave lidhur me Pjesën Liruese B.)

5.1 Lidhur me pikën I të aktgjykimit.

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë deklaratës së të akuzuarit SH.I, i cili e kishte mohuar kryerjen e veprës penale për të cilat është akuzuar, për shkak se një deklaram i tillë, gjene mbështetje edhe në deklaramet e tij të mëparshme, të dhëna para zyrtarëve policor dhe pranë prokurorit të shtetit, ku e kishte mohuar kryerjen e kësaj veprë penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari SH.I kishte qenë pjesë e grupit me të akuzuarit B.J, SH.H, P.H, F.H dhe B.B, të cilët pa autorizim kishin transportuar dhe shitur substanca narkotike të llojit kokaine dhe marihuanë, siç janë përshkruar veprimet në pikën I të aktakuzës.

Nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, raportet e përgjimit, vëzhgimit si dhe raportet e tjera dhe në asnjërën nga këto nuk ka mundur që të gjejë apo te jetë përmendur që ka qenë i përfshirë edhe i akuzuari SH.I, në veprimtarin e grupit. I njëjti nuk është përmendur as në deklaramet e ndonjërit prej dëshmitarëve të cilët gjykata i ka dëgjuar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Fakti se i akuzuari SH.I, ishte gjetur dhe arrestuar në banesën e të akuzuarit SH.H ditën kritike me datën 07.10.2018, kur janë arrestuar edhe të akuzuarit e tjerë, nuk e bënë si veprim inkriminues për shkak se me asnjë provë gjykata nuk e ka vërtetuar faktin se i njëjti ishte marrë qoftë me shpërndarjen, shitjen apo transportimin e narkotikut për grupin, sipas pikës I të aktgjykimit.

Gjykata në tërësi ia ka falë besimin mbrojtjes së të akuzuarit SH.I., i cili gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se atë natë kishte shkuar në banesën e Sh. dhe P.Ht, për të shikuar lojën e futbollit Liverpool - Manchester City dhe nuk kishte ditur se pse kishin ardhur policia në banesën e të akuzuarit Sh., dhe se i njëjti nuk e ka ditur se Sh.i është marrë me narkotikë se po ta kishte ditur

⁷ Trupi gjykues, duke u bazuar në nenin 360 par.2 të KPP-së në të cilën është parashikuar se “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, ka vendosur që bëjë ricilësimin e veprës penale të përshkruar si në arsyetim.

do të ishte larguar nga ai. Edhe i akuzuari SH.H deklaroi se në banesën e tij ditën kritike me SH.In ka qene duke luajtur sony.

Në rastin konkret PSRK, nuk ka arritur të vërtetoj se cilat kanë qene veprimet inkriminuese të akuzuarit SH.I në grup me të akuzuarit si në pikën I të aktgjykimit dhe se cilat janë provat që e vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit, për shkak se përveç kallëzimit penal në të cilin konstatohet se: *“në Ferizaj në rrugën “...” në banesën në të cilën të dyshuarit kanë marrë me qera për të ushtruar veprimtari kriminale, janë arrestuar SH.H, F.H, P.H dhe SH.I, si dhe nga kontrolli i banesën janë gjetur dhe sekuestruar substance e dyshuar e llojit kokaine, substance e dyshuar narkotike e llojit marihuane dhe sende të tjera të ndryshme si monedha, telefona, dokumente, kartela bankare, vetura dyshohet se të dyshuarit në vazhdimësi i kanë shfrytëzuar për të shitur substanca narkotike”*. Gjykata nuk ka gjetur ndonjë provë apo shkresë në të cilën përmendet i akuzuari SH.I, pra nuk është vërtetuar se cili ka qene roli dhe veprimtari e tij në grupin për të cilin është akuzuar, çoftë për shpërndarje, shitje apo transportim të narkotikut, të cilat janë elemente thelbësore të veprës penale dhe po ashtu nuk është vërtetuar me asnjë provë se në cilin rast i njëjti kishte vepruar çoftë për shpërndarje, shitje apo transportim të narkotikut siç është vërtetuar me prova për të akuzuarit e tjerë e të cilat janë elaboruar në pjesën dënuese të aktgjykimit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, pas administrimit të provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të çdo prove një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari SH.I, ta ketë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 dhe nënpar 1.2 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin të pjesës liruese të këtij aktgjykimi.

5.2 Lidhur me pikën II të aktgjykimit.

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari B.B ka kryer veprën penale veprës penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit, siç është përshkruar në pikën II të pjesës liruese të aktgjykimit.

Siç është theksuar edhe më lartë elementet e veprës penale të Shperlarjes së parasë, janë përcaktuar sipas nenit 56 par.1 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në të cilat përcaktohet se: *“Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon: nënparagrafi 1.1. përcakton se: “konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit,*

vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë”; nënparagrafi: 1.2 përcakton se: konvertion, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij; ndërsa nën paragrafi 1.5 përcakton se: “fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla”.

Sipas aktakuzës në pikën VII si veprime inkriminuese për të akuzuarin B.B janë konstatuar se: *“i akuzuari kishte në pronësi automjetin IMT539 me shënime tjera si në dispozitiv si dhe kishte në përdorim automjetin Audi A4 me shënime tjera si në dipsoziv e cila ishte e regjistruar në emër të motrës së tij H. B., e nga të gjeturat hetimore nuk ka prova se të njëjtat janë si rezultat nga ndonjë aktivitet i rregullt ekonomik ose burim tjetër i ligjshëm i njohur, por nga të ardhurat e aktiviteteve të dyshuara-veprimtaria e kundërligjshme e trafikimit me narkotik”* dhe është dhënë kualifikimi se ka kryer veprën penale pastrimi i parave nga neni 56 i Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Gjykata nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se PSRK në aktakuzë, në pikën VII-të në veprimet e të akuzuarit nuk ka përcaktuar se cilat nga veprimet e paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, 1.2 dhe 1.5 të nenit 56 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i ka kryer-konsumuar i akuzuari, pra nuk janë përcaktuar cilat nga veprimet konkrete inkriminuese i ka kryer i akuzuari, a ka bërë konvertim apo transferim, apo maskim apo ka fshehur prejardhjen e pasurisë, gjegjësisht cilin nga këto veprime i ka bërë në raport me pasurinë e tij e cila është dyshuar apo ka mundur të jetë si burim i veprës apo që ka ndihmuar tjetrin në pasurinë e tij dhe që vërtetojnë se pasuria e tjetrit është burim i veprës apo i aktivitetit kriminal.

Siç është theksuar më lartë neni 56 Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, nuk e inkriminon faktin e vetëm e të qenurit në pronësi apo përdorim të një pasurie, por duhet dhe kërkohet të vërtetohet përtej çdo dyshimit të bazuar mirë që pasuria e caktuar të cilën i akuzuari mund ta ketë në pronësi apo përdorim buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal apo që kjo pasuri në të vërtetë është fituar me vepër penale, që dhe sipas dispozitave të lartpërmendura kërkohet që pasuria pastaj të jetë transferuar, maskuar, fshehur dhe shkaqet tjera të përcaktuara sipas kësaj dispozite.

Në rastin konkret sipas aktakuzës i akuzuari akuzohet se ka në pronësi automjetin IMT539 me shënime tjera si në dispozitiv që nga data 12.09.2016, ndërsa automjetin Audi A4 me shënime tjera që nga data 12.09.2017, e për të cilën prokuroria pretendon se kjo pasuri të ketë qenë nga të ardhurat e aktiviteteve të dyshuara e të kundërligjshme të trafikimit me narkotik.

Gjykata ka ardhur në përfundim se vet aktakuza thekson se: *“nga të gjeturat hetimore nuk ka prova se të njëjtat janë blerë si rezultat i ndonjë aktiviteti të rregullt ekonomik ose burimi të ligjshëm”* mirëpo nga provat e administruara nuk është vërtetuar që kjo pasuri të ketë rrjedhë nga ndonjë aktivitet kriminal apo është si rrjedhojë e veprës penale, që në rastin konkret me asnjë provë nuk është dëshmuar se pasuria është përfituar qoftë nga aktiviteti kriminal apo është si rrjedhojë e veprës penale, ashtu që nga formulimi i veprimeve inkriminuese të lartshënuara gjykata konsideron se PSRK është mundur që barrën e të provuarit në rastin konkret të ia kalojë

të akuzuarit, ashtu që gjykata në këtë drejtim konsideron se nuk mund t'i lihet barra e provës të akuzuarit që ta dëshmojë pasurinë e cila ka mundur të rrjedhë si rrjedhojë e aktivitetit të rregullt ekonomik dhe se në rastin konkret i takon prokurorisë që të dëshmojë përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se kjo pasuri burim i ndonjë aktiviteti kriminal apo edhe i veprës penale.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se nga raporti përmbledhës i hetimeve financiare të policisë së Kosovës i datës 28.01.2019 është vërtetuar se automjeti IMT me shënime tjera si në dispozitiv të akuzës është në pronësi që nga data 12.12.2016, pra kjo pasuri nga ana e të akuzuarit është përfituar para periudhës përkatësisht para veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor e që prokuroria e konsideron si aktivitet të dyshuar veprimtari të kundërligjshme të narkotikëve, pra nga kjo nuk vërtetohet se i akuzuari ishte marrë qoftë me transportimin, shitjen e narkotikut para kësaj periudhe.

Lidhur me automjetin Audi A4 me shënime tjera si në dispozitiv të akuzës nga provat e administruara gjykata nga raporti përmbledhës i hetimeve financiare ka vërtetuar se vetura e lartpërmendur ishte blerë nga H. B motra e të akuzuarit B.B, e cila është në pronësi të saj që nga data 12.09.2017, dhe e njëjta e kishte blere nga shitësi V. F. me çmimin prej 9,200 euro, të cilën pagesë palët kishin deklaruar se e kishin bërë jashtë zyrës së noterisë.

Po ashtu, edhe dëshmitarja H..B, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se veturën e kishte blerë me para të cilat ja kishin dhënë vëllezërit e saj H., dhe B. B, të cilët jetojnë jashtë e të cilët ja kishin bërë si dhuratë për shkak të martesës së vonshme. Ajo ka theksuar se veturën e kishte lënë në shtëpinë e prindërve të saj, pikërisht tek vëllau i saj B.B pasi që i njëjti nuk ka pasur veturë të tij dhe ai ka jetuar me prindërit të cilët ishin të sëmurë dhe i ka pasur fëmijët e vegjël dhe i njëjti në atë kohë ishte i pa punë. Prandaj gjykata në këtë drejtim ka ardhur në përfundim se vetëm fakti që ishte në pronësi dhe përdorim i akuzuarit të automjeteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nuk e vërteton faktin se të njëjtat ishin përfituar nga ndonjë aktivitet kriminal apo të cilat mund burojnë nga ndonjë vepër penale, për shkak se siç është theksuar edhe me lartë nuk është vërtetuar më asnjë provë se i akuzuari më parë a është marrë me ndonjë aktivitet kriminal të trafikimit të narkotikëve për shkak se i akuzuari për veprën penale nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së është shpallur fajtor për periudhën kohore 16.05.2018 deri më datën 07.10.2018, prandaj gjykata nga provat e administruara nuk ka mundur të vërtetojë faktin se pasuria e të akuzuarit e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit të ketë qenë qoftë burim i ndonjë aktiviteti kriminal apo edhe i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuarit, për shkak se të njëjtat në posedim dhe përdorim të akuzuarit kanë qenë para kësaj periudhe, pra automjeti IMT ishte në pronësi të akuzuarit nga data 12.12.2016, ndërsa automjeti Audi A4 ishte në pronësi të motrës së tij që nga data 12.09.2017, dhe se i akuzuari e kishte në përdorim që sipas dëshmitares është vërtetuar se e njëjta ia kishte lënë për arsye se i akuzuari i mbikëqyrte prindërit e saj se i njëjti kishte fëmijët e vegjël dhe në atë kohë ishte i pa pune.

Gjykata në këtë drejtim ka ardhur në përfundim se prokuroria fare nuk ka ndërmarrë veprime hetimore sa i përket prejardhjes së parave me të cilën ishte blere vetura Audi A4, për të cilën dëshmitarja H. B. kishte deklaruar se e njëjta veturën e kishte blerë me paratë të cilat ia kishin dhënë vëllezërit H..dhe B. B. të cilët jetonin jashtë, prandaj gjykata sa i përket këtij fakti ia ka falur besimin dëshmisë së dëshmitares H. B. se paratë e njëjta i kishte pranuar nga vëllezërit e saj.

Lidhur me pretendimin e aktakuzës se “nga të gjeturat hetimore nuk ka prova se të njëjtat janë blerë si rezultat i ndonjë aktiviteti të rregullt ekonomik ose burimi të ligjshëm”, ky pretendim ka mbeture vetëm në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo të bazuar mirë, ashtu që gjykata duke u bazuar edhe në parimin “*In dubio pro reo*” nën 3 par.2 të KPP-së, në cilin është përcaktuar se “*mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”, gjykata nuk ka mundur ti vërtetojë faktin se pasuria e përkrahur si në dispozitivin VII të aktakuzës të ketë rrjedhë apo që është burim i ndonjë aktiviteti kriminal apo të jetë përfituar me veprë penale, prandaj nga të lartpërmendurat ka ardhur në përfundim se nuk është vërtetuar se i akuzuari B.B ka kryer veprën penale pastrimi i parave nga neni 56 par.1 nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

6. Elementet e veprave penale

- Në nenin 273 paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge e kryen: “*Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet*”. Ndërsa në nenin 281 të KPRK-së, është përcaktuar Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga Kapitulli XXIII, në paragrafin 1 përcaktohet se: Nëse vepra penale nga nenet 273, 274, 275, 276 ose 278 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse: nënparagrafi 1.1. kryesi vepron si anëtar i grupit. Ndërsa në nenin 81 të KPRK-së, është përcaktuar dënimi për veprat penale në vazhdim, në paragrafin 1 përcaktohet se: “*Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: nënparagrafët: 1.1.viktims së njëjtë të veprës penale; 1.2.objekti i njëjtë i veprës; 1.3.shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4.vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe 1.5. dashja e njëjtë e kryesit*”.

- Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen: “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”. Këto elemente kanë të bëjnë me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

- Në nenin 273 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge e kryen: “*Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet*”. Ndërsa në nenin 33 të KPRK, është parashikuar ndihma si formë e

bashkëpunimit ashtu që paragrafi 1 ka parashikuar që: *“Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës”*.

- Në nenin 308 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Shpërlarja e parave e kryen: *“Kushdo që kryen vepër penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit”*. Në nenin 56 par.1 të Ligjit Nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit është parashikuar se formën themelore të veprës penale sipas këtij neni e kryen: *“Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon: nënparagrafi 1.1. përcakton se: “konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë”; nënparagrafi: 1.2 përcakton se: konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij; ndërsa nën paragrafi 1.5 përcakton se: “fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla”*.

7. Vendimet e trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë dhe në nenin 365 par.1 dhe 2 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre dhe atë:

- Të akuzuarit SH.H, B.B dhe F.H, i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën janë ngarkuar me aktakuzë në pikën I, ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkuara në dispozitivin I të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në vazhdimësi nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

- Të akuzuarin B.B, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë në pikën II, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkuara në dispozitivin II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

- Të akuzuarin A.H, e ka shpallur fajtor për veprën penale për pikën III të aktakuzës e cila pikë është rikualifikuar nga ana gjykatës, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkuara në dispozitivin III të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale: Ndhimë në kryerjen

e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

- Të akuzuarin SH.H, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është ngarkuar me aktakuzë në pikën IV, ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin IV të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale: Shpërlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

- Të akuzuarin SH.B dhe A.M i ka shpallur fajtor për veprat penale, ashtu të akuzuarin Sh. B për pikën V të aktakuzës e cila pikë është rikualifikuar nga ana gjykatës, ndërsa të akuzuarin A.M për pikën VI të aktakuzës e cila pikë është rikualifikuar nga ana gjykatës, ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara në dispozitivin V dhe VI të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale: shpërlarje e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 nënpar.1.6 lidhur me 1.2 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

- Ndërsa po ashtu duke u bazuar në këto që u cekën më lartë dhe në nenin 364 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së trupi gjykues i liroi nga akuza të akuzuarit SH.I dhe B.B, për kryerjen e veprave penale, siç janë cekur në pikën I dhe II të pjesës liruese dispozitiv të këtij aktgjykimi.

8. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata, gjatë vendosjes për dënimin, nuk gjeti ndonjë rrethanë tejet lehtësuese por si rrethana relativisht lehtësuese ndaj të akuzuarve mori: **gjendjen e tyre materiale**, ku gjendja e tyre materiale është nën mesataren familjare, ku të akuzuarit para kryerjes së veprës - veprave penale, kishin gjendje të mesme ekonomike, ku me rastin e arrestimit të tyre është përkeqësuar edhe gjendja materiale e tyre; **të akuzuarit janë mbajtës të vetëm të familjes**, ndërsa i akuzuari B.B përkujdeset materialisht edhe për dy fëmijët e tij të moshës së re, ku me rastin e arrestimit të të akuzuarit, është përkeqësuar edhe gjendja e përkujdesi material ndaj tyre, pasi që këta fëmijë të moshës së re nuk mundë të përkujdesen për veten e tyre e as për familjen; të akuzuarit SH.B dhe A.M **nuk kanë qenë të dënuar më herët për veprë penale**, në bazë të të dhënave që posedon gjykata për këta të akuzuar, por edhe të dhënave të ofruara nga organi akuzës, nuk është vërtetuar se këta të akuzuar kanë rënë ndesh me ligjin më herët, respektivisht nuk janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë, apo të kenë vuajtur ndonjë dënim, **sjellja e të akuzuarve gjatë gjykimit**, të gjithë të akuzuarit kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ku sjellja e tyre ka qenë korrekte ndaj gjykatës dhe palëve në proces gjyqësor, duke respektuar edhe rendin e procedurën në gjykatore.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin për të akuzuarit SH.H, B.B dhe F.H si rrethana tejet rënduese ka konsideruar:

- **Kryerjen e veprës penale si grup**, ku vepra penale nga të akuzuarit është kryer si grup, respektivisht vepra penale e narkotikut, ku të akuzuarit kanë vepruar si anëtar grupi në kryerjen e kësaj vepre penale e që përbënë edhe me përcaktimin ligjor të veprës penale (kualifikimin juridik të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor) rrethanë tejet rënduese për ashpërsimin e dënimit, pra rrethana për të cilën ligji e ka ashpërsuar edhe dënimin;
- **Rrezikshmëria - vlera e mbrojtur shoqërore**, veprat penale të narkotikut, gjithnjë e më shumë po shkojnë drejt trendit të rritjes, ku trendi i rritjes së këtyre veprave penale në shoqëri dhe sasia/lloji i narkotikut të konfiskuar në këtë çështje penale, tregon shkallën e rrezikshmërisë së lartë të kësaj vepre penale (rrezikshmërinë e lartë të veprimeve inkriminuese të këtyre të akuzuarve), ku kjo rrezikshmëri e lartë kriminale, cenon edhe vlerat më të mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e qytetarëve, posaçërisht ku përdorues të narkotikut janë grup-moshat e reja si vlerë e rëndësishme e shoqërisë.

Përpos rrethanave tejet rënduese të cilat janë theksuar sikurse më lartë, gjykata si rrethana rënduese i ka konsideruar:

- **Shkallën e përgjegjësisë penale**, ku varësisht pjesëmarrjes dhe rolit të të akuzuarve në kryerjen e veprave penale, gjykata për disa nga të akuzuarit bazuar në këtë rrethanë ka shqiptuar dënim më të ashpër në krahasim me të akuzuarit e tjerë, ku të akuzuarve: Sh. B. dhe F..., u ka shqiptuar dënimin më të ashpër në krahasim me të akuzuarit tjerë. Këta të akuzuar në raport me të akuzuarit e tjerë kanë qenë më shumë të involvuar në kryerjen e veprës penale të narkotikut, ku B.B dhe F. B., kanë bërë sigurimin ndërkuftar të narkotikut, ndërsa i akuzuari Sh. është marrë me shpërndarjen dhe shitjen e narkotikut.
- **Motivi i kryerjes së veprës penale**, motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë motivi financiar. Të akuzuarit për motive të tyre financiare, respektivisht për përfitim material, kanë anashkaluar të gjitha interesat e përgjithshme shoqërore, kanë anashkaluar jetën, sigurinë dhe shëndetin e përgjithshëm të qytetarëve. Kjo nën kupton se të akuzuarit në veprimet e tyre nuk kanë kursyer asgjë në drejtim të kryerjes së veprës penale, respektivisht motivi financiar i tyre i kryerjes së veprës penale ka qenë primar në raport me interesin e përgjithshëm, ku pa mëdyshje e kanë ditur se veprimet e tyre janë të kundërligjshme (përbëjnë vepër penale) dhe se narkotiku paraqet rrezik të përgjithshëm shoqëror, mirëpo motivi i tyre i përfitimit material i ka tejkaluar ato.
- **Sjelljen e mëparshme të kryesit**, faktin se i akuzuari **SH.H**, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i përgjithshëm me numër P.nr.2835/2017, i plotfuqishëm me datën 29.06.2018, ka qenë i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro, për shkak të veprës penale; Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, po ashtu ka qenë i dënuar me Aktgjykimin e plotë fuqishëm të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Krimeve të Rënda me numër të smil-it 2021:214292, i plotfuqishëm me datën 20.12.2021, me dënim me gjobë në shumë prej 400 euro, për shkak të veprave penale; Mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe me dënim me

kusht për veprën penale; Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 të KPRK-së. Ndërsa i akuzuari **F.H**, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda me numër PKR.nr.523/2013, i plotfuqishëm me datën 24.07.2013, ka qenë i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 700 euro, dhe dënim me kusht për shkak të veprës penale; Blerja, posedimi shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope apo anologe nga neni 273 par.1 të KPRK-së. I akuzuari **B.B**, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me numër PKR.119/2013, plotë fuqishëm me datën 09.09.2014, ka qenë i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit e 7 muaj, për veprën penale; Kontrabandim me emigrant nga neni 138 par.6 i KPRK-së. I akuzuari **A.H**, me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i përgjithshëm me numër P.nr.665/2018, i plotfuqishëm me datën 15.02.2019, ka qenë i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 100 e për veprën penale; Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, prandaj nga të lartpërmendurat vërtetohet të njëjtit edhe më herët kanë rënë ndesh me ligjin.

- **Për të akuzuarin A.H**, gjykata duke marrë për bazë faktin se të njëjtin e ka gjykuar për veprën penale Ndihmë që sipas nenit 33 par.1 të KPRK-së thuhet se: *“kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër me kryerjen e veprës penale dënohet me dënim më të butë”*, si dhe duke marrë për bazë faktin, përkatësisht sasinë e narkotikut për të cilën i njëjti i ka ndihmuar të akuzuarit SH.H që ka qenë në sasi prej 5.54 gram, gjykata këto rrethana i ka vlerësuar lehtësuese dhe ka ardhur në përfundim se në rastin duhet aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit nga nenin 75 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPRK-së, prandaj edhe ka shqiptuar dënim nën kufijtë që parasheh neni 76 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ngase ka vlerësuar se edhe me dënimin burgim të shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit për këtë të akuzuar.

Prandaj, duke marrë për bazë të gjitha të cekurat e lartpërmendura gjykata ardhur në përfundim se në rastin me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të akuzuarit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së dhe se këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojnë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjykata, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit A.H dhe mbrojtësit të tij avokatit Ahmet Ahmeti dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2000) Euro, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

9. Vendimi mbi konfiskimet

Gjykata me këtë aktgjykim, të akuzuarve iu ka shqiptuar edhe dënimin plotësues, respektivisht marrjen e sendit (konfiskimin) e sendeve të përdorura e të destinuara, për kryerjen e veprave penale. Të akuzuarit, gjatë kryerjes së veprës penale kanë përdorur sende, para dhe automjetet e konfiskuara sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Automjete i kanë përdorur në transportimin, përcjelljen dhe vëzhgimin e rrugës gjatë transportimit të narkotikut dhe automjetet kanë qenë pasuri të cilat janë fituar nga mjetet financiare të veprimtarisë e kundërligjshme trafikimit me narkotik.

- Substanca narkotike e llojit “Kokainë” në peshë neto të përgjithshme prej 2 ± 0.0001 gram, është konfiskuar si objekt i veprës penale meqenëse e njëjta është gjetur në banesën e të akuzuarve e cila sasi nuk është konfiskuar sipas aktgjykimit paraprak të kësaj çështje me numër PS.nr.43/19 të datës 11.11.2019;
- Shuma e parave në vlerë prej tremijë e njëqind e dhjetë (3110) Euro; si në dispozitivin I të pjesës së konfiskimit, kjo shumë është konfiksuar për arsye se e njëjta është gjetur kryesisht në banesën e të akuzuarve Sh., F.. dhe P.H e cila shumë ka ardhur si rezultat i kryerjes së veprës penale të pikës I të aktgjykimit.
- Për pikën II të konfiskimit ku janë konfiskuar nga i akuzuari B.B dhe atë: Një (1) peshore digjitale, Një (1) revole e tipit Zastava M-57, e kalibrit 7.62 mm, me numër serik: H-99359, së bashku me një (1) karikatorë dhe nëntë (9) fishek të kalibrit 7.62 mm; Një (1) revole e kalibrit 6.35 mm, me numër serik: 493788, së bashku me një (1) karikatorë dhe katër (4) fishek, dyzetnjë (41) fishek të kalibrit 7x64mm si dhe gjashtë (6) fishek të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12 mm; Një peshore digjitale ngjyrë të kaltër në të hirit; Para në shumë prej 836 Euro e 5 cent, dhe atë me bankënotat si në vijim 7x100 Euro, 2x50 Euro, 1x20 Euro, 1x10 Euro, 1x5 Euro, 1x1 Euro, 1x5 cent, 170 Denar të Maqedonisë, Një (1) Telefoni Iphone 7, ngjyrë e zezë me IMEI: 35804082621000; Një (1) Telefon Samsung, GT-1080, me numër serik 89355020000276436837025; Një (1) Telefon Samsung, ngjyrë ari, gjykata të njëjtat i ka konfiskuar si objekte të veprës penale dhe po ashtu si mjete të cilat janë përdorur dhe përfituar me kryerjen e veprës penale nga pika I dhe II e aktgjykimit.
- Për pikën III, IV, V të konfiskimit ku janë konfiskuar nga të akuzuarit F.H dhe SH.H dhe atë: Një (1) telefon Samsung Galaxy S8, ngjyrë e zezë, IMEI:358793083011419; Një (1) jelek antiplumb ngjyrë të kaltër; Një (1) telefon Iphone 6s, ngjyrë ari-vjollce; Një (1) telefon Iphone 7 plus, ngjyrë e bardhë; Një telefon Iphone 5, ngjyrë Ari, me SIM kartelë 044-823-008 , IMEI:352036064128778, Një (1) telefon Samsung Duos E0168, ngjyrë e bardhë; Një (1) Samsung G850F, ngjyrë e bardhë, pa kartel, me numër IMEI:356010/06/594567/6, të gjitha si objekte të kryerjes së veprave penale, një (1) telefon Iphone 6, ngjyrë e bardhë, një telefon (1) Nokia ngjyrë e zezë, një (1) Iphone 6 ngjyrë hiri, gjykata të njëjtat i ka konfiskuar si objekte të veprës penale dhe po ashtu si mjete të cilat janë përdorur me kryerjen e veprës penale nga pika I e aktgjykimit.

Automjetet e përdorura dhe të fituara si pasuri nga mjetet financiare të veprimtarisë së kundërligjshme të trafikimit me narkotik, respektivisht automjeti:

- Një (1) automjet i markës “Audi 4”, tipi B8, ngjyrë e zezë metalike, me numër identifikues të automjetit .. me targa të regjistrimit .., e cila është pronë e të akuzuarit F.H por që evidentohet në emër të B. A..ky automjet është vërtetuar se ishte përdorur nga i akuzuari F.H për sigurimin e narkotikut i akuzuari F..me datën 04.08.2018 kishte udhëtuar për në Republikën e Shqipërisë së bashku me të akuzuarin B.B. Po ashtu sa i përket kësaj veture nga dëshmia e dëshmitarit B. A. është vërtetuar se ishte blerë nga i akuzuari SH.H derisa i akuzuari F.H në atë kohë ishte në burg dhe shumë prej 9.000 euro dëshmitari B. A.ia kishte dhënë SH.Ht.
- Një (1) automjeti i markës BMW 187, me targa .., ngjyrë e kaltër, viti 2008, me numër identifikues të automjetit ..; Një (1) automjet i markës BMW 328, me .. ngjyrë hiri, viti 1998, VIN n...; këto automjete është vërtetuar se janë pasuri të cilat janë fituar nga mjetet e përfituara me kryerjen e veprës penale, përkatësisht nga veprimtaria e kundërligjshme e shpërndarjes dhe shitjes nga ana e të akuzuarit SH.H.

Duke u bazuar në nenin 62 par.1 dhe 2 nënpar.2.7, nenin 69 dhe 96 par.1 dhe 2 dhe nenin 374 par.3 të KPRK, si dhe në nenin 282 par.2 nënpar.2.1 dhe 2.3 të KPP-së, trupi gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarve të konfiskohen mjetet/sendet që janë përdorur me qëllim të kryerjes së veprës penale dhe të cilat janë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendimin për refuzimin kërkesa për konfiskimin e shtatëdhjetepesëmijë (75.000) Euro apo ekuivalenti i kësaj shume, këtë kërkesë e ka refuzuar si të pa bazuar në ligj për shkak se fillimisht prokurori nuk kishte bërë hetim të posaçëm financiar në këtë çështje, shuma prej 75,000.00 eurove asnjëherë nuk ishte sekuestruar apo konfiskuar si shume e posaçme gjatë procedurës paraprake nga gjykata, gjykata edhe në fjalën përfundimtare nga prokurori ka kërkuar që të arsyetohet bazën ligjore të propozimit për konfiskimin e ekuivalentit të shumës prej 75,000.00 Euro, ashtu që trupi gjykues ka ardhur në përfundim se sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013, nuk është parapare me ndonjë dispozitë që gjykata mund të bëjë konfiskimin ekuivalent të shumës e cila nuk i është gjetur të akuzuarve, dhe se kjo procedurë mund të bëhet pas një hetimi të posaçëm financiar sipas Ligji nr.04/l-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, prandaj këtë kërkesë është refuzuar si e pa bazuar me ligj.

Gjykata sa i përket substancave narkotike të përshkruara si në dispozitivin I të aktgjykimit dhe atë: substancës narkotike kokainë në sasi prej 549.44±0.0001 gram dhe substancës narkotike kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (THC) në sasi prej 5.54±0.0001 gram, të njëjtat nuk i ka konfiskuar me këtë aktgjykim për shkak se të njëjtat janë konfiskuar me aktgjykimin e kësaj gjykate PS.nr.43/19 të datës 11.11.2019 me të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit B.J dhe P.H.

10. Vendimi mbi kthimin e sendeve të pjesës liruese

Gjykata duke u bazuar në nenin 116 të KPP-së, të akuzuarit B.B i janë kthyer sendet të cilat ishin sekuestruar përkatësisht automjetet që janë përshkruar si në pikën II tek pjesa e aktgjykimit për shkak se gjykata nuk e ka vërtetuar faktin se të njëjtat kanë qenë dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale apo të cilat janë përdorur me kryerjen e veprës penale, prandaj është bërë kthimi për shkak se nuk ka pasur bazë për konfiskimin e tyre.

11. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 par.1 dhe 453 të KPP-së dhe konform nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në pjesën gjykyese trupi gjykues ka vendosur që të akuzuarit t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa në pjesën lirues trupi gjykues ka vendosur që shpenzimet të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për pjesën gjykyese konform nenit 365 të KPP-së, ndërsa për pjesën lirues konform nenit 364 par.1 nënparg.1.4 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- DEPARTAMENTI SPECIAL -
PS.nr.16/19, me datë 17.01.2022

Zyrtarja ligjore,
Mirjetë Demiri

Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë – Departamenti Special, nëpërmjet kësaj Gjykate.